

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7710 E enjte 15 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga SHEZAI RROKAJ

Kongresi i Manastirit, gur themeli i gjuhës dhe i kombit



Letër

Kryeministri

Nga LIMOS DIZDARI

Një propozim për të ndihmuar artin në Shqipëri

Në katër ngjarjet kombëtare më të mëdha historike, gjuhësore e letrare, kulturore e arsimore, shtetformuese, të cilave u janë referuar dhe do t'u ...
Vijon në faqet 20-21

Më ndjenjën e konsideratës dhe respektit për ju dhe punët e mira që bëni për vendin, po ju drejtohem me kërkesën tonë, për të mundësuar që Qendra ...
Vijon në faqet 21



Autorët me skafandra, gjendet motori i djegur

Kaos në Shkodër, vritet me plumb në kokë tregtari në mes të markatës

Atentati, plagoset edhe Fatmir Mehaj. Viktima, i afërm i Arjan Ferracakut që u vra më 1 shtator

SENAD NIKSHIQI

SHKODËR - Nuk kanë të ndalur atentatet e përgjakshme në Shkodër. Një ditë pas takimit të zëvendësministrit të Brendshëm Sandër Lleshaj me krerët e policisë në Shkodër, një tjetër ngjarje e rëndë ka ...
Në faqet 2-3

LISTA ME 5700 EMRA, DOKUMENTET QE MUNGOJNE NE DOSJEN E SECILIT

TE PERNDJEKURIT, KUSH E PERFITON DEMSHPERBLIMIN

Pjesa e pestë/ Ministria e Financave publikon trashëgimtarët që do të ndajnë fondin financiar. 3 muaj afat për plotësimin e dokumentacionit



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë

Në faqet 11-13

KORRUPSIONI

Nikolla Gruevski gjen azil politik në Hungari, pranga 2 ministrave në Shkup

Në faqet 17

PERBUSHET AMANETI

Mid'hat Frashëri prehet në atdhe, ceremonia bën bashkë PS e PD

Në faqet 19

FUTBOLL

Skandali i bastesve sportive, në dosjen italiane përmendet edhe emri i Igli Tares

Në faqet 22

LITERATURA, ME GABIME

Apeli i studentëve: Universitetet shtetërore kanë tarifa të kripura

Në faqet 9

BIEN 4 AKUZAT



Ishte dënuar me 4 vite burg, Apeli shpall të pafajshëm Shpëtim Gjikën

Në faqet 7

Presidenti: Zgjidhje e drejtë për qytetarët. Veliq: Shpellarë, deputetët e Saliut

Protesta tek Unaza e Re, Meta: I shqetësuar

Lulzim Basha: Skemë korruptive, 40 milionë euro për 2 kilometra rrugë

Presidenti Ilir Meta kërkon vendosjen sa më parë të dialogut mes institucioneve shtetërore dhe banorëve të zonës së "Astirit", që protestojnë për prishjen e banesave dhe njësitë të tyre tregtare, që preken nga projekti i zgjerimit të Unazës së Madhe. Njëpërmyet një reagimi



të shpërndarë dhe në mbrëmje nga Presidencia, kryetari i shtetit vë theksin te nevoja që të gjitha ankesat që kanë banorët të shqyrtohen me seriozitet nga institucionet shtetërore. "Presidenti i Republikës, Ilir Meta po ndjek me shqetësim dhe ...
Në faqet 4-5

PERPLASJA MES BANDAVE ATENTATI

Policia zbardhi vetëm një ngjarje. Ende mister zhdukja e nip e dajë

Krimi në nën thundër Shkodrën, në 6 muaj u vranë 7 persona dhe u plagosën disa të tjerë

*Përplasia mes bandave kriminale në qytet nisi
me atentatin ndaj të "fortit" Lulzim Kulla*

SHKODËR

Përplasia mes bandave kriminale në Shkodër ka pasur me një sërë atentatesh mafioze dhe me bilanc tragjik viktimash. Vetëm në 6 muajt e fundit të këtij viti janë ekzekutuar 7 persona, mes të cilëve dhe Fatos Ferracaku, i cili mbeti i vrarë mesditën e djeshme. Ndërkohë që në ngjarjet e bujshme që kanë tronditur qytetin janë plagosur shumë persona, ndërsa janë denoncuar të zhdukur edhe dy persona të tjerë. Gjithçka nisi në fillim të janarit të këtij viti, ku pas një shpërthimi me tritol mbeti i plagosur biznesmeni Lulzim Kulla si dhe shtatë të tjerë. Atentati i 13 janarit ndaj të "fortit" të Shkodrës (Kullës), do të pasonte pesë muaj më pas me vrasjen Mehdi Kavajës, pronar i një servisi makinash. 60-vjeçari u qëllua për vdekje me plumb në kokë, në banesën e tij. Pavarësisht hetimeve të kryera, kjo ngjarje ka mbetur mister, pasi nuk dihet motivi dhe as autorët e krimit. Një muaj më pas dhe konkretisht më 18 korrik të këtij viti u ekzekutua në një atentat mafioz ish-efektivi i policisë Boran Bërçana dhe bashkëjetuesja e tij, Silvana Ndoci. Ata u qëlluan me breshëri automatiku (me 28 plumba) brenda në makinë dhe afër banesës së tyre në sy të djalit 2-vjeçar, i cili i mbijetoi atentatit. Dy ditë më parë u zbardhën detaje të reja në lidhje me këtë ngjarje që shokoi Shkodrën. Mësohet se një intrigë çoi në ekzekutimin e ish-policit Bërçana dhe bashkëjetueses e tij. Hetimet kanë zbuluar se përhapja e një thashethemi ka pasur për qëllim futjen në konflikt të bandave rivale në Shkodër. Për këtë arsye u përhap fjala sikur Boran Bërçana ishte shprehur "unë e shtypa butonin e bombës ndaj Lul



31-vjeçari i vrarë
Arjan Ferracaku



Ish-polic i vrarë, Boran Bërçana
dhe bashkëjetuesja Silvana Ndoci

PERSONAT E VRARË

1. Mehdi Kavaja, më 18 qershor
2. Boran Bërçana, më 15 korrik
3. Silvana Ndoci, më 15 korrik
4. Fatbardh Lici, më 10 gusht
5. Prendush Fusha, më 27 gusht
6. Arjan Ferracaku, më 1 shtator
7. Fatos Ferracaku, më 14 nëntor

PERSONAT E ZHDUKUR

1. Agron Mollaj, më 23 gusht
2. Gëzim Hysaj, më 23 gusht

Kullës". Në të vërtetë, sipas një burimi të "ABC News", Boran Bërçana nuk e kishte deklaruar një fakt të tillë dhe ai nuk kishte pasur lidhje me ngjarjen. Pas verifikimeve, ai ndodhej në Spanjë për llogari të një grupi kriminal. Por vendimi i ekzekutimit ishte marrë. Dhe jo vetëm për ish-policin, por edhe për bashkëjetuesen e tij, e cila cilësohej si person që kishte dënuar për shumë ngjarje. Edhe ky atentat nuk është zbardhur nga policia vendore. Afro një muaj më vonë, më 10 gusht të këtij viti u vra në një atentat Fatbardh Lici. 53-vjeçari ishte duke pirë kafe në një lokal në Kiras, kur u qëllua me breshëri kallashnikov. Pas ngjarjes, policia bëri me dije se dyshohet që Lici në vitin 2011 ka qenë i përfshirë në vrasjen e Astrit Kurmema. Por vetëm kaq, pasi autorët e krimit ende nuk janë zbuluar. Më 23 gusht u denoncuan të zhdukur nga familjarët Agron Mollaj dhe Gëzim Hysaj (dajë e nip), ndërsa nuk dihet ende asgjë për fatin e tyre. Më 27 gusht u vra pas një konflikti për motive pronësie Prendush Fusha, ndërsa u arrestua autori. Kjo është e vetmja ngjarje e zbardhur gjatë verës së "nxehtë" të këtij viti. Por, seriali i vrasjeve vijoi me ekzekutimin mafioz të biznesmenit Arjan Ferracaku. Ngjarje kjo e ndodhur më 1 shtator të këtij viti. 31-vjeçari ishte duke shëtitur me kalë kur u qëllua për vdekje. Viktima, pronar i dy bizneseve në Velipojë dhe baba i dy fëmijëve u gjet i vrarë në periferi të qytetit të Shkodrës, ku zakonisht janë gjetur makina të përdorura për krime dhe të djegura. Edhe vrasja e biznesmenit ende nuk është zbardhur. Ndërkohë që mesditën e djeshme u ekzekutua po një atentat mafioz, kushëri i tij, Fatos Ferracaku.



Vendi ku ndodhi atentati me një të vrarë dhe një të plagosur

Dënimi, OSBE: Kriminelët në burg

"Shullazi", Ambasada e SHBA-ve:
Pas tij kush e ka radhën?

TIRANË - Dënimi me 14 vjet burg i Emiljano Shullazit nga Gjykata e Krimeve të Rënda, e cila dha 55 vjet burg në total për anëtarët e bandës së tij ka pasur me reagimin e disa ambasadave në Tiranë, mes të cilave ambasada e SHBA-ve, Britanisë së Madhe dhe ajo gjermane. Vendimi është mirëpritur edhe nga OSBE-ja. Në një reagim në rrjetet sociale, Ambasada e SHBA-ve thotë: "Dita e djeshme shënoi një hap domethënës përparë për qytetarët shqiptarë, që kërkojnë dhe meritojnë drejtësi të vërtetë nga sistemi i tyre gjyqësor. Ne u inkurajuar nga puna e prokurorëve shqiptarë, të cilët, duke u bazuar në prova, bindën gjykatësit e Krimeve të Rënda se një bos i krimit dhe kriminelë të tjerë e kanë vendin në burg. Përshtetësim shqyrtimin e kujdesshëm të këtij rasti. Vendimi i marrë është një fitore për sundimin e ligjit në Shqipëri. Qytetarët shqiptarë tani pyesin "Kush e ka radhën?" Dhe Ambasada e Britanisë së Madhe ka përshtetësimin e gjykatave shqiptare për dënimin e bandës së Shullazit. "Ambasadori Duncan Norman mirëpritë vendimin e gjykatave shqiptare për të dënuar me 14 vite burg Emiljano Shullazin dhe dënimet e gjata të dhënat për bashkëpunëtorët e tij. Krimi i rëndë dhe i organizuar gërryen vazhdimisht ekonominë, shkatërron jetët dhe dëmton komunitetet tona. Nuk duhet të ketë hapësira të sigurta që të veprojnë kriminelët e krimit të rëndë dhe të organizuar", tha ambasada në një postim në rrjetet sociale. Në lidhje me dënimin e grupit të Shullazit ka reaguar edhe ambasadorja e Gjermanisë, Susanne Schutz. Diplomati gjermane shprehet se askush nuk mund të qëndrojë mbi ligjin, ndërsa i ka bërë apel drejtësisë shqiptare që të mos tërhiqet në burgosjen e elementëve kriminalë. "E kam ndjekur me vëmendje procesin ndaj 5 të pandehurve në çështjen 'Shullazi'. Askush nuk qëndron mbi ligjin, drejtësia shqiptare të vazhdojë të veprojë. Lufta kundër krimit dhe korrupsionit është detyrë e Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Europian", ka deklaruar ambasadorja gjermane.



Ndërsa, në reagimin e OSBE-së thuhet: "Jemi të inkurajuar nga operacionet e muajve të fundit kundër krimit të organizuar dhe së bashku me qytetarët shqiptarë që respektojnë ligjin, presim të shohim më shumë arrestime dhe dënime të kriminelëve të rrezikshëm".



Senad Nikshiqi

SHKODËR

Nuk kanë të ndalur at entitetet e përgjak shme në Shkodër. Një ditë pas takimit të zëvendësministrit të Brendshëm Sandër Lleshaj me krerët e policisë në Shkodër, një tjetër ngjarje e rëndë ka tronditur banorët e këtij qyteti. Viktima e radhës është një tjetër pjesëtar i fisit Ferracaku. Bëhet fjalë për 40-vjeçarin Fatos Ferracaku (person pa precedent penal), i cili u ekzekutua me plumb në kokë në mes të ditës, ndërsa mbeti i plagosur kunati i tij, Fatmir Mehaj. Burime zyrtare nga policia e kryeqendrës së verit bënë me dije se ngjarja me një të vrarë e një të plagosur ndodhi në lagjen "Rus", në zonën e njohur si Markata. Mësohet se viktimja dhe 48-vjeçari Mehaj (të dy tregtarë peshku) ishin duke pirë kafe bashkë në një lokal, kur dy persona me një motorçikletë tip "TMAX 550 kubik dhe skafandra në kokë janë afruar dhe kanë qëlluar në drejtim të tyre. Për pasojë, dy tregtarët kanë mbetur të plagosur rëndë dhe janë dërguar në spitalin rajonal të Shkodrës, ku dhe iu është dhënë ndihma e parë mjekësore. Pavarësisht ndihmës së dhënë nga bluzat e bardha, 40-vjeçari Ferracaku nuk ka arritur t'u bëjë ballë plagëve të marra. Ndërsa, kunati i tij ndodhet jashtë rrezykut për jetën. Krismat e armës kanë terrorizuar banorët e shumtë, ndërsa policia ka shkruar shpejt në vendngjarje dhe ka nisur hetimet. Mësohet se vetëm pak minuta pas ngjarjes, policia vendore e Shkodrës ka gjetur motorçikletën, me të cilën dyshohet se është kryer krimi në zonën e Zooteknikës, afër Livadeve, një zonë kjo e përdorur kohë e fundit për djegjen e mjeteve pas krimeve që kryhen në Shkodër. Pas kryerjes së veprimeve hetimore para-prake, burime policore pohuan për "Gazeta Shqiptare" se dyshohet që atentati është kryer nga vrasës profesionistë me pagesë vetëm pak meta larg vendit, ku në janar të vitit 2018 iu vendos tritol Luzlim Kullës, i njohur ndryshe si "i forti" i Shkodrës.

ATENTATI

Sipas burimeve nga policia e Shkodrës, rreth orës 11:15, Fatos Ferracaku ka qenë duke pirë kafe me mikun e tij, Fatmir Mehaj, kur dy persona që lëviznin me motorçikletë kanë ndaluar afër tyre. Njëri nga atentatorët është ulur nga mjete dhe ka qëlluar 8 herë me pistoletë në drejtim të 40-vjeçarit Ferracaku, që dyshohet se ka qenë objektivi. Në rast ka ndërhyrë Mehaj (motra e këtij të fundit është gruaja e vik-

Dyshimi, policia: Atentatorët, vrasës me pagesë. Banorët: Pamë tmerr me sy!

Atentat në mes të qytetit, ekzekutohet me 5 plumba në kokë dhe trup Fatos Ferracaku

Po pinin kafe në lokal, plagoset rëndë kunati



Viktima Fatos Ferracaku



Vendi ku ndodhi ngjarja



Kryeministri Rama: Të fortët le të hanë kokën e njëri-tjetrit

SHKODËR - Vrasja në atentat e 40-vjeçarit Fatos Ferracaku dhe plagosja e kunatit të tij, Fatmir Mehaj ndodhi një ditë pas vizitës së zëvendësministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj në policinë vendore të Shkodrës. Për mbi dy orë, Lleshaj zhvilloi këtë takim, ku ka dhënë disa porosi të qarta për të gjithë drejtuesit sa i përket luftës ndaj krimit të organizuar, korrupsionit, kontrollit për elementët kriminal që mund të lëvizin në qytet, por edhe një patrullim të shtuar në akse të ndryshme problematike. Të nesërmen e kësaj vizite (dje), Shkodra u trondit nga një tjetër ngjarje e rëndë me një të vrarë dhe një të plagosur. Po një ditë para ngjarjes, kryeministri Rama deklaroi gjatë një interviste televizive: "Këta që hanë kokën e njëri-tjetrit, s'ndjej gjë veçse marr frymë thellë. Këta që hanë kokën e njëri-tjetrit, ta hanë dhe mos u ngopshin".

"Autorët u larguan në mbledhjen e organizatës kriminale Rilindja"

Berisha: "Forca e krimit" godet përsëri në Shkodër, maskat ekzekutojnë në mes të tregut biznesmenin

TIRANË - Pas ngjarjes së rëndë në Shkodër, ka reaguar ish-kryeministri Sali Berisha. Përmes një postimi në "Facebook", Berisha ka ironizuar operacionin "Forca e Ligjit" duke e quajtur "Forca e krimit". Ish-kryeministri shkruan se pas krimit, maskat u larguan për në mbledhjen e organizatës Rilindja. "Operacioni 'forca e krimit' godet përsëri në Shkodër! Maskat ekzekutojnë në mes të tregut të qytetit



një biznesmen dhe plagosin rëndë një tjetër. Maskat largohen për në mbledhjen e organizatës kriminale Rilindja. Do takohen me Ditzj Bus-

hatin për të dërguar porosinë e Kallam Dësh-takut për konkurrencën me kallashnikov", - shkruan Berisha.

DINAMIKA E VRASJES

Njëri nga atentatorët është ulur nga mjete dhe ka qëlluar 8 herë me pistoletë në drejtim të 40-vjeçarit Ferracaku, që dyshohet se ka qenë objektivi. Në rast ka ndërhyrë Mehaj (motra e këtij të fundit është gruaja e viktimës) ka dalë para autorit për ta ndaluar, por për pasojë ka mbetur i plagosur. Sipas mjekëve, 48-vjeçari ka marrë dy plumba sipër këmbës së majtë, afër legenit. Ndërsa Ferracaku ka marrë plumba në kokë, në gjoks dhe në këmbë.

ar se nuk e kanë parë ngjarjen, pasi janë frikësuar dhe janë larguar nga aty. Ndërsa kanë rrefyer se autorët nuk i kanë njohur, duke qenë se mbanin skafandra në kokë.

Thjesht kanë raportuar për dy persona me motorçikletë dhe asgjë më shumë. "Pamë tmerr me sy. Nuk i njohëm vrasësit", janë shprehur tregtarët e kalimtarët. Në polici janë shoqëruar edhe persona të tjerë, të cilët dyshohen se mund të kenë dijeni për këtë ngjarje të rëndë. Ende janë të paqarta arsyet e kësaj vrasjeje. Viktimja dhe kunati i tij merreshin me tregtinë e peshkut, duke shitur të merkata e Rusit. Sipas hetuesve të çështjes, atentati është kryer nga vrasës me pagesë. Të dy autorët, ai që ka qëlluar dhe tjetri që e shoqëronte nuk kanë gabuar dhe janë tregtar të qetë e të ftohtë në çdo vepër të tyre. Policia ka sekuestruar pamje filmike në akset ku mendohet se kanë lëvizur dy shtetasit, por është vështirë të identifikohen, pasi mbanin skafandra në kokë.

BANORËT NË TERROR

Zona ku ndodhi atentati ka pasur lëvizje të madhe, sepse aty është merkata, ka shumë dyqane të tjera dhe kanë qenë një numër i madh personash në lëvizje. Tregtarët e tjerë që qëlluan afër, por edhe kalimtarët e rastit janë shokuar nga kjo ngjarje, ndërsa janë frikësuar sepse plumbat mund t'i kapnin edhe ata. Shumë prej atyre që ishin afër kanë vrarë duke tentuar që të largohen sa më shumë, në mënyrë që t'u shpëtojnë plumbave.

timës) ka dalë para autorit për ta ndaluar, por për pasojë ka mbetur i plagosur. Sipas mjekëve, 48-vjeçari ka marrë dy plumba sipër këmbës së majtë, afër legenit. Ndërsa, Ferracaku ka marrë 3 plumba në kokë, 1 në gjoks dhe 1 në këmbë. Po sipas bluve, dy autorët janë treguar profesionistë, duke qëlluar me saktësi në drejtim të Fatos Ferracakut. Ata janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes.

Zona ku ndodhi atentati ka pasur lëvizje të madhe, sepse aty është merkata dhe shumë dyqane të tjera dhe kanë qenë një numër i madh personash në lëvizje. Tregtarët e tjerë që qëlluan afër, por edhe kalimtarët e rastit janë shokuar nga kjo ngjarje, ndërsa janë frikësuar sepse plumbat mund t'i kapnin edhe ata. Shumë prej atyre që ishin afër kanë vrarë duke tentuar që të largohen sa më shumë,

në mënyrë që t'u shpëtojnë plumbave. HETIMET Fatos Ferracaku është kushëriri i Arjan Ferracakut, ky i fundit i vrarë në shtator të këtij viti në zonën periferike të Livadeve. Policia ka shoqëruar disa shitës të tjerë, që rastisën në vendin ku ndodhi vrasja dhe plagosja për t'u pyetur lidhur me atë çfarë kanë parë dhe çfarë ka ndodhur. Shumë prej tyre kanë deklaruar

Shitje me Ankand të trete nga Studio Permbarrimore L.D.C

1. "Nderetese", me sipërfaqe 600 m², me Nr. Pasurie 495/15, Volum 5, faqe 83, ndodhur në Zonën Kadsatrale 3426 me adresë në Tullinë, Tiranë. Regjistruar në Zyren Vendore Regjistrimit Pasurive Palauajshme Tiranë. Çmimi fillestar për shitje është 2.116.800 leke.

Data e shpalljes 30.10.2018
Data e zhvillimit 03.11.2018 deri në orën 16.00

Ankand i zhvillohet në ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adresë Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

PROTESTA AKUZAT

Valentina Madani

Protestës së banorëve në zonën e "Astirit" në Tiranë, iu bashkua mbrëmë edhe kreu i opozitës, Lulzim Basha. Sipas Bashës, Partia Demokratike pas një hetimi disaditor nxjerrë në dritë disa fakte tronditëse. Pas takimit me protestuesit, z.Basha në deklaratën për mediat tregoi dy dokumente që sipas tij nuk lejojnë prishjen e banesave pa u marrë dëmshpërblimi. Konkretisht, VKM 'Proces legalizimi' e vitit 2011 tregon standardin ligjor të vendosur nga qeveria "Berisha", që pronarët e banesave në proces legalizimi të kompensohen me vlerë të plotë tregu, kur banesat e tyre preken nga projektet me interes publik. VKM 'Shpronësimit' e vitit 2012 provon që për projektin e Unazës së Madhe janë kompensuar me vlerë të plotë tregu edhe banesa që janë klasifikuar nga ALUIZNI në kategorinë "Proces legalizimi". Shkeljet sipas tij janë: "1 kemi të bëjmë me një propozim fantazmë. 2 - I projektuar në kushte antiligjore. 3 - Pa leje bashkiake". "Së pari, projekti është i paligjshëm pasi vjen nga një propozim i pakërkuar. Një inxhinieri i ka lindur në zemër të bëjë duratë një projekt për këtë pjesë të Unazës në shkelje totale të normave të projektimit, i përshtatshëm për autostrada. E dyta, është skema korruptive. 40 mln euro për 2 km me shtatë nënkallime dhe mbikalime. E treta, projekti duhet të miratohet nga pushteti vendor. Në kulmin e kësaj paligjshmërie, bashkia duhet të thoshte nuk do ta pranojë këtë projekt. Ka në krye një fundërrinë, i cili del dhe sulmon qytetarët me shprehje raciste, që tregojnë se plehrat e Sharrës janë më të pastra se shpirti i tij", deklaroi z.Basha. Kreu i opozitës, Lulzim Basha njoftoi dhe se gjatë këtyre ditëve opozita ka hetuar dhe ka konstatuar shkelje në rastin e projektit të Unazës së Madhe. "Arsyeja e këtij takimi ishte për të treguar disa të vërteta për shkeljet ligjore, pasi e ligjshme është vetëm protesta e tyre. Pas një hetimi disaditor kanë dalë fakte tronditëse, pasi projekti është i pakërkuar, firma e ka paraqitur jashtë normave, pasi ky projekt është për autostradë dhe jo për këtë rrugë". Kreu i PD iu kthye deklaratave për Teatrin Kombëtar kur tha se, "e kam thënë është vijë e kuqe, por shtëpitë tek Unaza e Re janë dy herë vija e kuqe për kryeministrin". "Kam thënë po u prish teatri, nesër do prishen shtëpitë e shqiptarëve. Nuk ka pritur ky kryeministër që çdo gjë e bën të paligjshme. Ashtu si teatri është vijë e kuqe, këtu është dy herë vijë e kuqe. Banorët kanë të drejtë

Veliaj: Shpellarë, deputetët e Saliut. Kreu i PD: Në krye të bashkisë, një fundërrinë

'Unaza e Madhe', Basha nxjerr dokumentet: Tri shkeljet e projektit

"S'lejohet prishja e banesave pa bërë dëmshpërblimin"



Nga protesta e dëshme e banorëve tek Unaza e Re

LULZIM BASHA

"Ky është një projekt që është bërë sikur fillet për një autostradë, ndërkohë që është Unazë e një qytetit. Së dyti, ky është një projekt i paligjshëm, pasi zhvillohet në qytet dhe duhet të ishte marrë mendimi i pushtetit vendor. Do të jemi në krah të banorëve për këtë padrejtësi që po u bëhet. Nuk do të lejojmë që ata të nxirren në rrugë", tha kreu i PD-së.

Kryemadhi: Rama largohet vetëm me protesta mbarëpopullore

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, ishte e pranishme dhe në një takim me kryesinë e LSI Durrës, nga ku u bëri thirrje shqiptarëve që të ngrihen e të rrëzojnë kryeministrin socialist. Kryemadhi shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar në të gjitha nivelet me partitë opozitare për çdo aksion kundër qeverisë "Rama". "Opozita është e bërë bashkë kundër këtij kryeministri. Politika e Rilindjes mbolli varfëri dhe krim në këtë vend. Rruga e vetme për largimin e Ramës është protesta mbarëpopullore", u shpreh ajo. Kryetarja e LSI theksoi gjithashtu se partia që ajo drejton është garancia për një Shqipëri më të mirë, larg krimi të organizuar dhe varfërisë. "LSI ka luajtur



edhe një rol të veçantë për rininë dhe gruan. Forcimi i strukturave të rinisë dhe gruas duhet të jenë imediat për shpëtimin e vendit nga krimi i organizuar", u shpreh kryetarja e LSI.

banorëve të Unazës së Re, si dhe sqaroi akuzat rreth termit 'shpellarë'. Kryebashkiaku sqaroi se shpellarë ka cilësuar deputetët e Saliut, që iu sulen barbarisht zonjave të Policisë Bashkiake "Shpellarë quajta deputetët e Saliut, që iu sulen barbarisht zonjave police të bashkisë! S'i quaj dot deputetë këta prehistorikë. Saliu i vrau me plumba në mish në bulevard, le më t'i lejonte të dera", shkruan Veliaj. Kryebashkiaku shkruan se shpronësimit për Unazën e Re, do të realizohen 100%, edhe pse shumica janë loto, lavazhe e 8 kate pa leje.

qiptarët t'u bashkohen banorëve protestës së banorëve tek Unaza e Re. "Në kushtet e shtetit ligjor, këta qytetarë kanë të drejtë të bëjnë gjithçka për të mbrojtur shtëpitë e tyre", deklaroi z.Basha.

REAGIMI

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, teksa u ngacmua nga gazetaret për deklaratën e kryebashkiakut Erion Veliaj se deputetët e PD ishin shpellarë, tha: "Smerrem me një njeri që e ka shpirtin më të zi se plehrat e Sharrës". Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj reagoi dhe në "Twitter" pas protestave të



Keu i PD-së, Lulzim Basha, dje me banorët e Unazës së Re



PD: Buxheti 2019 i qeverisë, në interes të oligarkëve

Partia Demokratike akuzoi dje se buxheti i qeverisë për vitin 2019 është vënë në interesin e oligarkëve. Sipas deputetes Jorida Tabaku, koncesionet dhe PPP-të do t'u kushtojnë shqiptarëve vitin e ardhshëm miliarda euro. "Metoda e shpikur nën këtë qeverisje me emrin PPP u ka kushtuar deri më tani shqiptarëve 2.2 miliardë euro. Në mënyrë të paprecedentë, në vitin 2019, për koncesionet do paguhet një vlerë prej 105 milionë eurosh, duke ua hequr këtë shumë investime në infrastrukturë, ujësjellës dhe shkolla. Kushdo që voton buxhetin 2019, në fakt ka votuar një buxhet në interesin e oligarkëve dhe një pakicë që dëshiron të skllavërojë shqiptarët nësoj siç dikur diktatura fameqëje moniste bëri me prindërit tanë", deklaroi deputetja Jorida Tabaku.



'Dako', PD: Prokuroria po fsheh provat e përgjimit me banditë

PD insistoi edhe dje se kryebashkiaku i Durrësit, Vangush Dako duhet të arrestohet. Deputetja e PD, Dhurata Çupi deklaroi se prokuroria hesht prej 3 javësh në mbrojtje të krim-it elektoral të Vangush Dakos. Sipas Çupit, është e faktuar se Dako ka blerë vota me bandat dhe i ka shpërblyer ato për fuqizimin ekonomik të tyre. "Nën urdhrat politikë të Edi Ramës, Prokuroria nuk po e heton Dakon, megjithëse është provuar publikisht se ai ka gënjyer për miqësinë dhe shkëmbimin e favoreve me bandën e Avdylajve. Vangush Dako ka qindra faqe përgjime me bandat në Durrës, të cilat prokuroria i disponon, por i fsheh, që të mos bëhen publike pazaret e kryetarit të Bashkisë së Durrësit për blerjen e votave, në këmbim të favoreve, lejeve, punësimeve, tenderave, pasurive publike të Durrësit", tha Çupi.

Shoqëria permbartimore JUSTITIA

Shoqëria permbartimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vene hipoteke NBG BANK, me këto të dhëna:
• Lloji i pasurisë Are+ Trull me sip. 3000 m² nr.pasurie 58/9 vol 8 fq78, z.k.1475, Derven, KRUIË
Çmimi më të cilin filon shitja në ankand është 96.000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) EUR. Ankandi zhvillohet në datën 04.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartësist gjyqësor, me
Adrese: Bulevardi 'Bajram Curri', Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890



Presidenti ka reaguar për protestën e banorëve të "Astirit" dhe kërkon dialog

Protesta, Meta: Institucionet të respektojnë të drejtat njeriut

"Të gjitha ankesat të vlerësohen me transparencë"

Presidenti Ilir Meta kërkon vendosjen sa më parë të dialogut mes institucioneve shtetërore dhe banorëve të zonës së "Astirit", që protestojnë për prishjen e baneve dhe njësitë të tyre tregtare, që preken nga projekti i zgjerimit të Unazës së Madhe. Njëpërmjet një reagimi të shpërndarë dje në mbrëmje nga Presidencia, kryetari i shtetit vë theksin te nevoja që të gjitha ankesat që kanë banorët të shqyrtohen me seriozitet nga institucionet shtetërore. "Presidenti i Republikës, Ilir Meta po ndjek me shqetësim dhe vëmendje situatën konfliktuale të krijuar në Tiranë mes qytetarëve dhe autoriteteve, për shkak të ndërimit të Unazës së Re. Presidenti Meta bën thirrje për vendosjen e një dialogu dhe konsultimi mes qytetarëve dhe autoriteteve, me qëllim që të gjitha ankesat të vlerësohen me transparencë dhe përgjegjësi, me qëllim arrijtjen e një zgjidhjeje të drejtë dhe objektive", thuhet në reagimin e Presidencës për këtë çështje.



Presidenti Ilir Meta

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha institucionet shtetërore duhet të tregojnë përgjegjësi në respektimin e plotë të tyre", mbyllet reagimi i institucionit të Presidentit të Republikës. Nga ana e saj, qeveria ka konfirmuar

gjatë këtyre ditëve se është e vendosur që t'i shkojë deri në fund realizimit të këtij projekti, që sipas saj do të çlirojë trafikun në një nga segmentet më problematike të Tiranës. Ndërkohë që ka bërë të ditur se një pjesë e 317 familjeve që pre-

ken nga projekti dhe që i kanë pronat të regjistruara do të shpronësohen sipas parashikimeve që bën ligji, ndërkohë që pjesës tjetër që nuk i ka pronat të regjistruara, do t'i ofrohet bonus qiraje për 3 vite.

DIALOGU

"Presidenti Meta bën thirrje për vendosjen e një dialogu dhe konsultimi mes qytetarëve dhe autoriteteve që të gjitha ankesat të vlerësohen me transparencë dhe përgjegjësi, me qëllim arrijtjen e një zgjidhjeje të drejtë dhe objektive", thuhet në reagimin e Presidencës për këtë çështje.



Rama: Platforma mund të bëjë atë që s'e bën dot një deputet

Kryeministri Edi Rama në takimin e tij të përjavshëm me qytetarët për platformën e bashkëqeverisjes ka dëgjuar edhe dje disa nga zgjidhjet që kanë ardhur prej saj, ndërsa ka bërë thirrje për përdorimin e kësaj mundësie për të zgjidhur problemet. Ai theksoi më tej se për 3 minuta një qytetar mund të vërë në lëvizje një mekanizëm të tërë për zgjidhjen e një problemi. "Një deputet nuk arrin dot që për 3 minuta ta vërë një ministër në shërbim të komunitetit apo një individ. Një qytetar arrin, pasi automatikisht paop çështja hyn në proces apo regjistrohet në portal, koordinohet në bashkëpunim edhe falë autoritetit që kanë nga titullari në një lëvizje mekanizmat. Në fund të çdo mbledhjeje qeverie del në ekran e gjithë lista e çështjeve të platformës së qytetarëve, sektor më sektor. Ajo që është dëgjuar në 20 e ca vite 'më jep votën që zëri yt të dëgjohej' ka qenë një slogan që nuk ka gjetur materializim kurrë. Sot është një realitet", deklaroi shefi i ekzekutivit.



Deputeti ka marrë pjesë edhe në mbledhjen e grupit

Robert Bitri kalon me PS, regjistrohet si deputet socialist

Robert Bitri u zgjodh në 2017-en për një mandat të dytë si deputet i Lëvizjes Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore të qarkut të Fierit, por pa kaluar një vit nga marrja e këtij mandati, ai u largua nga radhët e LSI-së ndërsa doli si deputet i pavarur. Por, ndonëse de juro ai ishte regjistruar si deputet i pavarur, de facto ishte një deputet i mazhorancës, pasi që nga shtatori ai ka votuar çdo nismë ligjore dhe vendim të paraqitur nga qeveria dhe socialistët në Kuvend. Ditët e fundit ai e ka konfirmuar këtë edhe në mënyrë ligjore, duke u regjistruar si deputet i grupit të Partisë Socialiste. Kjo gjë është reflektuar edhe në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë në internet, ku Robert Bitri rezultoi si pjesë e grupit parlamentar të Partisë Socialiste. Tashmë me këtë afrim, grupi parlamentar i Partisë Socialiste ka 74 deputetë të regjistruar, ndërsa gëzon mbështetjen edhe të 5 deputetëve të tjerë, të cilët aktualisht janë regjistruar si të pavarur. Burime nga PS kanë bërë të ditur se një kërkesë të tillë për t'u bërë pjesë e këtij grupi parlamentar kanë bërë edhe deputetët Rene Lala dhe Elena Xhina, por kjo nuk është konfirmuar prej tyre. Madje, Elena Xhina ka deklaruar për "Gazeta Shqiptare" se nuk ka bërë një kërkesë të tillë.

Kuvendi, letër prokurorisë: Në çfarë faze janë hetimet për CEZ

Kuvendi i Shqipërisë i kërkon zyrtarisht Prokurorisë së Tiranës informacione se deri në çfarë janë hetimet mbi çështjen "CEZ". Në kërkesën që sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, Genci Gjonçaj, i ka drejtuar prokurorisë së Prokurorisë së Tiranës, Elisabeta Imeraj, kërkon që përvç informacioneve të vihen në dispozicion kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta që organi i akuzës disponon. Kjo kërkesë vjen pak ditë pasi prokurorët kërkuar nga gjykata zgjatjen e afateve të hetimit edhe për tre muaj të tjerë. "Duke qenë se afati 3-mujor për zgjatjen e afatit të hetimeve i vendosur nga gjykata ka përfunduar me datë 31.10.2018. Kuvendi i Shqipërisë në cilësinë e palës së interesuar në këtë proces kërkon të na informoni në lidhje me statusin ku ndodhet hetimi i kësaj çështjeje, si dhe të na vini në dispozicion kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta që dispononi", shkruhet në kërkesë.

Shoqëria përparimorë JUSTITIA

Shoqëria përparimorë JUSTITIA shpall ankandim, faza e parë - për shpalljen e pasurisë së paluajtshme, por le cilat ka vlera hipotekë NBS Bank, me këllë të dhënës: - Ligji nr. 189 mbi regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të z.Ajfan Rahmi BAHOLLI. Çmimi me të cilin fillon shëja me ankand është 250.000 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) EUR - Ligji apartamenti sip 122m2 zik.5350 nr.pas.5188ndeni, zik.8350 vol 28 fq146 RRP-Myoqari TIRANË në pronosi të z.Ajfan Rahmi BAHOLLI. Çmimi me të cilin fillon shëja me ankand është 105.000 (njëqind e pesë mijë e gjashtëqind) EUR - Ankand zivillshet në datën 03.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përparimorë gjyqësor, me adresë Bulevardi' Bajram Curri', Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studijustitia.com, tel. +355 4 2270890

"Është edhe shenjë e degradimit politik të kësaj qeverie"

Opozita nuk ftohet në Bruksel, Pollo: Kanë frikë nga e vërteta

Pavarësisht gatishmërisë së shprehur dje në Bruksel nga përfaqësuesi i qeverisë shqiptare, Ditmir Bushati për të nisur dialogun me opozitën, kjo e fundit është përjashtuar nga takimi i radhës i Këshillit të Stabilizimit Asocimit Shqipëri-BE. Kështu të paktën pretendon kryetari i komisionit parlamentar të Integritimit, Genc Pollo, i cili nëpërmjet një reagimi për "Gazeta Shqiptare" tha se për herë të dytë qeveria përjashtoi opozitën nga përfaqësimi në takimin e Këshillit të Stabilizimit Asocimit Shqipëri-BE. "Për herë të dytë qeveria Rama shkel mbi traditën pozitive të përfaqësimit bipartizan në Bruksel vetëm me zyrtarë si

REAGIMI

"Për herë të dytë qeveria 'Rama' shkel mbi traditën pozitive të përfaqësimit bipartizan në Bruksel me zyrtarë si shprehje e vullnetit konsensual për integrim evropian. Edhe sot, ashtu si dhe një vit më parë, qeveria 'Rama' u paraqit në Bruksel vetëm me zyrtarë si Bushati e të tjerë, por pa kryetarin e këtij komisioni për integrimin evropian, të cilit nuk ju dërgua ftesë".

e vullnetit konsensual për integrim evropian. Edhe sot, ashtu si dhe një vit më parë, qeveria Rama u paraqit në Bruksel vetëm me zyrtarë si

Bushati e të tjerë, por pa kryetarin e këtij komisioni për integrimin evropian, të cilit nuk ju dërgua ftesë", thuhet në reagimin e Pollos. Që në

vitin 2011 Qeveria e Partisë Demokratike krijoi precedentin pozitiv të përfshirjes së kryetarit të Komisionit parlamentar për Integrimin Evropian, asokohe Ditmir Bushati, në takimet vjetore të Këshillit të Stabilizimit Asocimit Shqipëri-Bashkim Evropian. Ky precedent pozitiv bazuar në mbështetjen konsensuale mazhorancë-opozitë të anëtarësimit të vendit në BE u kthye në traditë deri në nëntor 2017. "Ky



Kryetari i Komisionit parlamentar të Integritimit, Genc Pollo

gjest nuk është vetëm frikë nga e vërteta e kriminalizimit të shtetit, me bandën e Bajrave e plot të tjera, gjë që nuk fshihet dot më as në Tiranë, Bruksel e gjetu. Është edhe shenjë e degradimit

politik të kësaj qeverie që rrrënon çdo trashëgimi politike pozitive që ka gjetur duke u kapur fort mbas karigres si i mbytur pas fajes së barit", - mbyll reagimin e tij Genc Pollo.

BE kërkon thellimin e luftës kundër krimit dhe miratimin e ligjit për gjyqtarët

Mogherini, thirrje politikës: Dialog, përmbushni reformat

"Duam një Ministri të Brendshme në funksion të plotë"

Bashkimi Evropian i kërkon politikës shqiptare që t'i japë zgjidhje sa më parë çështjes së plotësimit të vendit vakant të ministrit të Brendshëm. Nga Brukseli, gjatë një konference të përbashkët për mediat me ministrin e Jashtëm të Shqipërisë, Ditmir Bushati, mbajtur pas takimit të Këshillit të Stabilizimit Asocimit, shefja e diplomacisë europiane, Frederica Mogherini, u shpreh se zgjedhja e ministrit të Brendshëm është thelbësore për BE-në. Ajo konfirmoi kështu mesazhin e dhënë nga ambasadori i delegacionit të BE-së në Tiranë, Luigi Soreca, ndërsa theksoi se është e domosdoshme një ministri e Brendshme në funksion të plotë. "Mund të konfirmoj mesazhin e ambasadorit Soreca. Ne, gjithashtu, e biseduam këtë edhe me ministrin Bushati. Është thelbësore për ne, për BE që të shohim një Ministri të Brendshme në funksion të plotë, dhe aktive", tha Mogherini në përgjigje të pyetjes së gazetarëve. Lidhur me këtë çështje ministri i Jashtëm Bushati theksoi se uron që ky mesazh i përfaqësueses së lartë të BE-së të lexohet nga presidenti. "Dua të besoj që mesazhi i qartë nga ana e Brukselit dhe e Washingtonit të dëgjohej qartë në Tiranë në mënyrë që racionaliteti të triumfojë në procesin politik dhe institucional në vend", tha Bus-



Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ditmir Bushati dhe shefja e diplomacisë europiane, Frederica Mogherini, dje në Bruksel

HATI. DEKLARATA

Nërkohë që pas takimit BE doli edhe me një deklaratë zyrtare ku ritheksoi nevojën jetike që Shqipëria të thellojë reformat. "Shqipëria duhet të konsolidojë progresin e bërë në Reformën në Drejtësi si dhe në procesin e vetingut," - thuhet në deklaratë. Bashkimi Evropian, gjithashtu,

kërkoj rezultate të prekshme në luftën kundër krimit dhe korrupsionit. BE-ja përsëriti nevojën kritike që Shqipëria të ruajë dhe të thellojë ritmin aktual të reformave, të konsolidojë më tej progresin e bërë në reformën gjyqësore, në veçanti përmes procesit të vettintit, dhe të shënojë rezultate të tjera të prekshme në luftën kundër korrupsionit

në të gjitha nivelet dhe në luftën kundër krimit të organizuar, veçanërisht kundër kultivimit dhe trafikimit të drogave, duke pasuruar rezultatet pozitive që janë arritur në luftën kundër kultivimit të kanabisit gjatë kësaj periudhe.

DIALOGU

BE-ja ritheksoi se dialogu konstruktiv ndërpartakidh bashkëpunimi në Kuvendin e Shqipërisë janë thelbësorë për përpërimin e mëtejshëm të reformave dhe për qëndrueshmërinë e përgjithshme të angazhimit në procesin e integritimit në BE. Në këtë kontekst, BE theksoi rëndësinë e ndjekjes në mënyrë të vazhdueshme të dialogut gjithëpërfshirës politik, ndërkojë që avancohet puna teknike në të gjitha komisionet relevante parlamentare, përfshirë atë në Komitetin ad hoc për reformën gjyqësore. BE nënvizoi nevojën që të gjitha palët të gjejnë konsensusin e nevojshëm për të ndryshuar ligjin mbi statusin e gjyqtarëve, i cili do të mundësojë rekrutimin e një numri më të madh kandidatësh të reja për gjyqtarë.

DIALOGU

"BE theksoi rëndësinë e ndjekjes në mënyrë të vazhdueshme të dialogut gjithëpërfshirës politik, ndërkojë që avancohet puna teknike në të gjitha komisionet relevante parlamentare, përfshirë atë në Komitetin ad hoc për reformën gjyqësore".

SHKURTE

Negotiatat, Bushati: Gati të dialogojmë me opozitën

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati në prani edhe të përfaqësues të BE, Frederica Mogherini, u shpreh se qeveria që ai përfaqëson është e hapur për dialog me çdo forcë politike opozitare. "Gjatë diskutimeve pata mundësi që të rikonfirmoj qëndrimin e qeverisë shqiptare, gatishmërinë e Ramës për të mbajtur hapur derën e dialogut me të gjithë aktorët politikë parlamentarë dhe aktorët e tjerë institucionale në funksion të jetësimit të prioritetëve që janë të rëndësishme për fatet e vendit. E kam fjalën për reformën gjyqësore dhe avancimin më të shpejtë të reformës në drejtësi", tha Bushati në fjalën e tij. Duke folur mbi rezultatet e takimit me zyrtarët e lartë evropian ai theksoi se ka një vlerësim sa i përket ecurisë së reformave, përfshi edhe atë në drejtësi. "Vetëngiu i gjyqtarëve dhe prokurorëve po sjell frytet e para duke adresuar edhe mungesën e besimit që qytetarët kishin tek institucionet e drejtësisë", u shpreh Bushati.

Meta me ministrin e Jashtëm francez: Mbështetje për negociatat

Presidenti Ilir Meta është takuar në Marsjë me ministrin e Jashtëm të Francës, Jean-Yves Le Drian. Kreu i shteti shqiptar dhe kreu i diplomacisë franceze biseduan për mbështetjen e Francës në hapjen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. "Kënaqësi e veçantë të bisedoja në Marsjë, me ministrin e Jashtëm francez, Jean-Yves Le Drian, jo vetëm për rëndësinë e bashkëpunimit në rajonin e Mesdheut. Presim vizitën e tij të ardhshme në Shqipëri dhe mbështetjen fort tek Franca për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian", thotë Presidenti Ilir Meta në një postim në rrjetet sociale. Presidenti Meta po zhvillon takime në Francë pas pjesëmarrjes në Paris në aktivitetin që shënon përfundimin e Luftës së Parë Botërore.

NJOFTIM Studio Përmbarimorë Zyber SHEHU zhvillon ankandin e I (Parë) për pasurinë: a. Pasuria Nr.2/99+3-30, vol 1, faqja 134, ZK 8572, e ndodhur në Lajgen "Loni Dhame", Lushnjë, e llojit apartament, me sipërfaqe 54m2, çmimi 1.320.000(Një milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë. Ankandi zhvillohet në datë 16.11.2018 në ambientet e Studios Përmbarimorë Zyber SHEHU me adresë: Pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Cel.06822089339, osë adresën e-mail:shehuzyber@yahoo.com

NJOFTIM ANKANDI Permbareuesja Gjyqësore Ermira Mhilli me adresë Lgji, "Qemal Stafa", Rr: "Don Bosko", perballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder njofton se nga data 12.11.2018 ora 16:00 me ambientet e saj do të zhvillohet ankandi i treta për shpëtim e pasurisë së palauajshme e llojit Ndertese, Kati i pare i perberë nga dy dhoma,benjo kondor,saloni dhe balkoni me sip:123 m2, me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592,Lgji, "Naim Gjylbegu" Rr.Sali Nivica Shkoder ne vleren 3.995.536 lekë (Tremilioni e pesëqind e nentëdhjetë e pesëmijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë leke) Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Raiffeisen Bank (per pjesmarrjen ne ankand) Ofertuesit te drejtohen prane Zyres se Permbareueses Gjyqësore Ermira Mhilli, ose te kontaktojnë nepermjet Nr.tel:0692219253 ose adreses se emailit. ermira.mhilli@hotmail.com

NJOFTIM ANKANDI Permbareuesja Gjyqësore Ermira Mhilli me adresë Lgji, "Qemal Stafa", Rr: "Don Bosko", perballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder njofton se nga data 12.11.2018 ora 16:00 me ambientet e saj do të zhvillohet ankandi i treta për shpëtim e pasurisë së palauajshme e llojit Ndertese, Kati perberë nga ndarje Dyqan, me sip:113 m2, me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592,Lgji, "Naim Gjylbegu" Rr.Sali Nivica Shkoder ne vleren 2.972.885 leke (dy mijëton e nentëqind e shtatëdhjetë e dhjetë e tetëqind e nentëdhjetë e pesë leke) Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Raiffeisen Bank (per pjesmarrjen ne ankand) Ofertuesit te drejtohen prane Zyres se Permbareueses Gjyqësore Ermira Mhilli, ose te kontaktojnë nepermjet Nr.tel:0692219253 ose adreses se emailit. ermira.mhilli@hotmail.com

Alma Liçaj e Apelit nxjerr pa faj ish-kryebashkiakun

Gjyqtarja rrëzon dënimin me burg të Shpëtim Gjikas

Rrëzohen 4 akuzat e prokurorisë

Një ditë para se të kalonte në sitën e vetingut, kryetarja e Gjykatës së Apelit në Vlorë, Alma Liçaj ka shpallur të pafajshëm ish-kryebashkiakun Shpëtim Gjika. Ai ka marrë pafajësinë në seancën gjyqësore të së hënës, me relatores Alma Liçaj, si dhe gjyqtarët Petrit Aliaj dhe Ilba Bezati. Para se të kalonte në Komisionin e Posaçëm të Apelit, gjyqtarja Alma Liçaj zgjodhi të gjykojë apelinin e çështjes me të pandehur Shpëtim Gjika, Artur Haxhi, Doriana Sulaj dhe Ridvan Mersinaj. Mbi Gjiken rëndorin 4 akuzat të ngritura nga Prokuroria e Vlorës "Shpërdorim detyre", "Falsifikim dokumentesh", "Fshehje e provave të krimit" dhe "Ndërtim i paligjshëm", të cilat ranë në Gjykatën e Apelit. Në të njëjtin proces është shpallur e pafajshme ish-shefja e Urbanistikës në Bashkinë e Vlorës, Doriana Beharaj. I përfshirë në këtë çështje, biznesmeni Artur Haxhi, pronar i një subjekti ndërtues është dënuar me 3 vite burg, konvertuar në tri vite shërbim prove për akuzën e falsifikimit të dokumenteve zyrtare me shumë se një herë. I fajshëm për akuzën e falsifikimit të dokumenteve është shpallur edhe Ridvan Mersinaj, i cili u dënua nga gjykata me një vit burg, të konvertuara në dy vite shërbim prove. Nga ana tjetër, Komisioni i Posaçëm i Apelit pas seancës dëgjimore një ditë më parë për gjyqtaren Alma Liçaj, pritet të japë verdiktin nëse ajo e kalon ose jo sitën e vetingut.



Ish-kryebashkiaku i Vlorës, Shpëtim Gjika

ÇËSHËTJA NË GJYKATËN E LARTË

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Vlorës për t'i dhënë pafajësi ish-kryebashkiakut Shpëtim Gjika ka "habitur" përfaqësuesit e akuzës, të cilët i thanë 'BIRN' se do ta dërgonin çështjen në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar që të lihej në fuqi dënimi i dhënë nga shkalla e parë.

DËNIMI NE SHKALLËN E PARË

Vitin e kaluar, Gjykata e Vlorës vendosi pafajësi për akuzat e ndërtimit të paligjshëm dhe shpërdorimin e detyrës, për ish-kryebashkiakun e Vlorës, Shpëtim Gjika, ndërsa për akuzën e falsifikimit të dokumenteve zyrtar gjykata vendosi 4 vite burgim dhe 1 vit burg edhe për akuzën e veprimeve, të cilat pengojnë zbulimin e së vërtetës. Ndërsa gjykata ka vendosur ta konvertojë dënimin në 2 vite shërbim prove për shkak të rrezikshmërisë së ulët që prezanton i dënuesi. Për ish-kreun Gjika, gjykata ka vendosur edhe ndalimin për tri vite të usht-

rimin të funksioneve publike. Po ashtu, Gjykata e Vlorës ka vendosur për ish-shefen e Urbanistikës në Bashkinë e Vlorës, Doriana Beharaj, e cila ka marrë pafajësinë për të gjitha akuzat.

I përfshirë në këtë çështje, biznesmeni Artur Haxhi, pronar i subjektit ndërtues "Turi&MZE" është dënuar me 3 vite burg, konvertuar në tri vite shërbim prove për akuzën e falsifikimit të dokumenteve zyrtare me shumë se një herë. I fajshëm për akuzën e falsifikimit të dokumenteve është shpallur edhe Ridvan Mersinaj, i cili është dënuar nga gjykata me një vit burg të konvertuara në dy vite shërbim prove.

DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE TIRANË

Kerkon një objekt me qera për ta përdorur për zyra me kriteret e mëposhteme.

1. Siperfaqja e objektit që kërkohej 220-250 m²
2. Dokumenti pronarie mbi objektin (certifikate ose vertetim pronarie dhe planimetrie)
3. Fondi limit 9 euro për m²
4. Ndërtesa të ndodhet brenda vijave kufizuese të qytetit Tirane në një rreze me të vogël se 0.5 km nga ndërtesa e DRSSH Tirane.
5. Ambient të ketë të instaluar ujë dhe energji dhe të ketë kushte të përshtatshme për ta përdorur si zyre ose si ambient për dokumenta arkivore, të ketë hyrje me vete dhe banjo.
6. Afati i dorëzimit të dokumentave do të jetë dt 21.11.2018 ora 11.00.
7. Te interesuarit duhet të paraqesin planimetriën, dokument që vertetojnë pronarin dhe ofertën ekonomike jo më vonë se ora 11.00 të datës 21.11.2018.
8. Pasi të dorëzohen dokumentacioni, komisioni i ngritur për këtë qëllim do të beje dhe vlerësimin e objektit para shpalljes së fituesit.



Implemented by **giz**
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

OPEN CALL FOR EXPRESSION OF INTEREST for the establishment of a pool of national civil engineering and/or architect experts to conduct engineering investment works of facilities in project area

1. Brief background of the programme

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH is implementing on behalf of the German Government the project "Climate-friendly, integrated waste and recycling management (CFISWM)". During the period June 2017 to March 2018, the CFISWM project supported the three Municipalities, Himara, Peqin and Rogozhina in preparing Integrated Municipal Solid Waste Management Plans. The Integrated Municipal Solid Waste Management Plans in Himara and Rogozhina, had foreseen that the pre-treatment of solid urban waste (sorting and composting) will be performed at the Himara, Vumblo Transfer Station. The process of treatment of recyclable waste materials will be collected and processed in Rogozhina Collection Centre.

2. Purpose of the call for expression of interest and application procedure

This open call for expression of interest is intended to cover short term assistance of project support for engineering investment works of sorting and composting/stabilization facilities for municipal solid waste.

The Application deadline: is 21 November 2018.

On the basis of the information provided in the application, the Programme assesses whether the applicants meet the criteria laid down below. The applicants will be informed by the Programme not later than 30th of November 2018 whether they have been included in the pool of potential experts or not.

3. Scope of work and description of main tasks

Scope of work

Finalising Documents for Detailed Design,
Preparation of Tender Documents and Participation in Awarding Process
Carry out Site-supervision/ Implementation
Participation in the Final Acceptance
Hand Over Process including Documentation

Description of main tasks

- Preparation of the final design plans for construction
- Draft the implementation project which includes the preparation of all necessary documentation
- Preparation of an explanatory report for the planned facility
- Preparation of a cost estimate for the buildings and outdoor facilities
- Prepare tendering documents
- The Consultant shall assume all engineering functions and duties in accordance with the contractual provisions made between GIZ and the building contractor
- All Technical Services as supervisor

4. Required skills and experience

- Construction engineer and/or architect diploma
- At least 8 years of technical competence and professional experience in construction design and supervision works
- Very good analytical capacity, interpersonal and communication skills and reporting;
- Very good command of written and spoken English and computer literate;
- Experienced in working in a multidisciplinary team;

5. Documents to be provided

Experts interested in the call are invited to send their application at any time prior to 21/11/2018. Each application shall include the following documents:

- a motivation letter explaining why the applicant would like to be part of these pool of experts and what experience he/she has related to the scope of work
- diploma and Curriculum Vitae (curriculum vitae – CV, in the European format, preferably not exceeding 3 pages).
- Additional supporting documents (e.g. publications or references) may be requested at a later stage.

All documents shall be submitted in English, by electronic means at the following address hermann.plumm@giz.de or artur.galanxhi@giz.de

OBSh: Vdekjet nga diabeti do të rriten me 50%

Fishat e diabetit falas edhe për studentët, Manastirliu: 72 mijë persona të prekur

Pas fëmijëve 0-18 vjeç, fishat e diabetit do të jenë falas edhe për studentët. Në Ditën Botërore të Diabetit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në një aktivitet të zhvilluar për ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me masat për parandalimin e diabetit, deklaroi se lehtësirat për këtë kategori do të shtohen. "Me buxhetin e vitit 2019 do të mundësojmë që edhe për studentët, pra të gjithë personat me diabet deri në 23 vjeç, fishat e diabetit të jenë falas, duke bërë një tjetër hap drejt lehtësimi të personave me diabet dhe familjeve të tyre", tha Manastirliu. Kjo e fundit, tha se 9.3% e personave 35-

50%

RITJE E VDEKJEVE NGA DIABETI

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, diabeti shkakton çdo vit 5% të vdekjeve globale dhe mendohet se vdekjet nga diabeti në 10 vitet e ardhshme do të rriten me 50%. Diabeti prek rreth 5% qind të popullsisë së botës dhe numri i të sëmurëve është vazhdimisht në rritje, duke u dyfishuar çdo 10 vjet.

kryer check-up janë me nivel glicemie mbi normën, një shifër shumë e lartë që tregon për rëndësinë që ka kontrolli periodik, për të parandaluar pasojat e diabetit", tha ministria. Kjo e fundit theksoi se qeveria ka garantuar trajtimin 72 mijë personave me diabet, me një financim prej mbi 16 milionë dollarë në vit vetëm për rimbursimin e barnave për diabetikët. "Personat me diabet përfitojnë falas 36 lloje barna që përbëjnë terapinë e plotë për këtë sëmundje. Ne kemi mundësuar prej pak ditësh një procedurë të re për lehtësimin e personave



me diabet që kanë nevojë për konsulta në QSUT. Nuk është më e nevojshme që pacientët nga rrethet të vijnë në QSUT, por konsultat po realizohen nëpërmjet telemjekësisë mes QSUT dhe spitalëve rajonale, ku vetë pacienti merr shërbimin dhe përfiton trajtimin me rimbursim,

pa pasur nevojë të bëjë kilometra të tëra për të ardhur në Tiranë", tha Manastirliu. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, diabeti shkakton çdo vit 5% të vdekjeve globale dhe mendohet se vdekjet nga diabeti në 10 vitet e ardhshme do të rriten me 50%.

70 vjeç që kanë kryer check-up janë me nivel glicemie mbi normën, dhe vendosi theksin mbi kontrollin peri-

odik. "Rezultatet e deritanishme të Kontrollit Mjekësor Bazë tregojnë se 9.3% e personave 35-70 vjeç që kanë

Erion Veliaj, thirrje qytetarëve: Regjistrohuni sa më shpejt, përfitoni nga mundësia

Regjistrimet e vendbanimeve në kryeqytet, ja kur është afati i fundit i amnistisë

Burime nga Bashkia e Tiranës: Gjodat, deri në 100 mijë lekë

Voltiza Duro

Qytetarët e Bashkisë së Tiranës, kanë kohë deri në muajin prill për të bërë regjistrimin e saktë të vendbanimit të tyre, në të kundërt do të penalizohen me gjobë, vlera e së cilës arrin deri në 100 mijë lekë të vjetra. Ditën e djeshme, kryebashkiaku Erion Veliaj, gjatë përrurimit të zyrave në Lagjen nr.13, i bëri thirrje të gjithë banorëve të Tiranës që të regjistrohen në zonën ku jetojnë, për të bërë kështu edhe ndarjen e duhur të buxhetit për çdo zonë. "Më e rëndësishme është se në vitin 2019 do të reflektojmë buxhet për këto njësi të reja, çka na mundëson që me të njëjtën cilësi që punojmë në sheshin "Skënderbej", të punojmë edhe tek tri njësitë e reja. Po ashtu, edhe për shërbime, siç lejët për ndërhyrje të brendshme, qytetarët do të kenë mundësi t'i marrin këtu", - tha Veliaj.

AMNISTIA

Ndërkohë, burime nga Bashkia e Tiranës bëjnë me dije për "Gazeta Shqiptare" se para 10 ditësh ka hyrë në fuqi amnistia që i shpëton nga ngarkimi me gjoja qytetarët që ende nuk kanë regjistruar vendbanimin. "Rreth një vit e gjysmë më parë, ka hyrë në fuqi ligji mbi regjistrimin e saktë të vendbanimeve të banorëve të kryeqytetit. Nëse ky regjistrim nuk kryhet gjoja mund të jetë deri në 100 mijë lekë të vjetra. Por ka më shumë se 10 ditë që ka hyrë në fuqi amnistia që i shpëton qytetarët nga ngarkimi i gjobave. Ata kanë afat deri në muajin prill të 2019-ës për të bërë regjistrimin e saktë të vendbanimit të tyre", thonë për



Kryebashkiaku Erion Veliaj me ministrin e Diasporës, Pandeli Majko



Erion Veliaj gjatë përrurimit të qendrës së shërbimit në lagjen 13

GJOBA

"Rreth një vit e gjysmë më parë ka hyrë në fuqi ligji mbi regjistrimin e saktë të vendbanimeve të banorëve të kryeqytetit. Nëse ky regjistrim nuk kryhet, gjoja mund të jetë deri në 100 mijë lekë të vjetra. Por ka më shumë se 10 ditë që ka hyrë në fuqi amnistia që i shpëton qytetarët nga ngarkimi i gjobave. Ata kanë afat deri në muajin prill të 2019-ës për të bërë regjistrimin e saktë të vendbanimit të tyre", - thonë për "GSH" burime nga Bashkia e Tiranës.

"GSH" burime nga Bashkia e Tiranës. Vetë kryebashkiaku, në fjalën e tij tha qytetarët mund të shfrytëzojnë mundësinë e krijuar nga qeveria dhe parlamenti për të transferuar vendbanimin në njësitë ku banojnë

realisht, duke përfituar nga amnistia. "Nuk ka nevojë të shkosh tek njësi e vjetër, transferimi ndodh automatikisht, pa asnjë gjobë. Është një mënyrë ideale për të pasur të gjithë shërbimet këtu, jo vetëm certifikatat,

por duke nisur nga 1 janari, edhe shërbimin e pasaportës e kartës së identitetit, duke qenë se edhe kompania "Alcatel" do i atashohet tri lagjeve të reja", -tha Veliaj. Ky i fundit shtoi se do të japë shembullin i pari, si përfitues i shërbimeve të zyrës më të re, duke bërë zhvendosjen e familjes së tij nga Njësia 2 në lagjen e re. "Do jem i pari që do përfitoj nga lagja e re, do transferoj Ajolën, Kajandin dhe veten time këtu, për disa arsye: Së pari, se qendrën e votimit do ta kem këtu dhe nuk ka nevojë të transferohem në pjesën tjetër të Tiranës; së dyti, shërbimet do t'i marr këtu", -tha kryebashkiaku.

LAGJET E REJA

Qytetarët që jetojnë në

BUXHETI

"Më e rëndësishme është se në vitin 2019 do të reflektojmë buxhet për këto njësi të reja, çka na mundëson që me të njëjtën cilësi që punojmë në sheshin "Skënderbej", të punojmë edhe tek tre njësitë e reja. Po ashtu, edhe për shërbime siç janë lejët për ndërhyrje të brendshme, qytetarët do të kenë mundësi t'i marrin këtu", - tha Veliaj.

qytetarët dhe që ky shërbim të reflektonte realitetin e Tiranës sot, që do të thotë: nëse Tirana është rritur përtej vijës së verdhë, tek Unaza e Re, Kodra e Diellit, Kopshti Zoologjik, Kopshti Botanik dhe Liqeni i Thatë dhe pjesa tjetër tek Frestku, midis Dajtit dhe Kinostudios, atëherë shërbimet tona duhet të reflektojnë këto realitete, ndaj fillojmë me promovimin e lagjes së parë. Njësia administrative 13 është këtu në Rr. Rrapo Hekali", theksoi Veliaj. Ndërkohë, afrimin e zyrave të shërbimit pranë qytetarëve e vlerësoi edhe ministri i Diasporës, njëkohësisht edhe deputeti i PS, Pandeli Majko. Ky i fundit vlerësoi edhe njëherë investimet e rëndësishme të bashkisë në këtë zonë. "Po fillojmë rikonsiderimin dhe rikonstruksionin e komuniteteve. Kjo që sot shikohet këtu si Lagja Nr. 13, nesër mund të jetë një njësi e re administrative, edhe si pasojë e atij investimi të madh të kryer nga Bashkia. Fillimisht, u rindërtuan rrugët, ishin rrugë fshati, ka ardhur autobusi atje ku nuk mendohej, dhe sot mund të flasim për një njësi të re administrative, e cila i bashkon natyrshëm qytetit të Tiranës, pasi kjo zonë, sidomos zona e Selitës, ka qenë një fshat me një distancë shumë të afërt me qendrën", -tha Majko.

zonën jugore të Tiranës, në Selitë, në Kodrën e Diellit apo edhe Liqenin e Thatë, nuk u duhet të shkojnë drejt Farkës apo Njësies 5 për të marrë një shërbim. Tashmë, shërbimet do t'u ofrohen shumë më afër, në zyrat e reja të Lagjes 13, në afërsi të Selitës, ku do të gjejmë jo vetëm mjedise më të mira, por edhe një staf të ri dhe të kualifikuar. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, vuri në pah edhe njëherë angazhimin e bashkisë për të ofruar shërbimet sa më pranë qytetarëve. "Jam dyfish i gëzuar: së pari, si kryetar i Bashkisë ka qenë ëndërr që të afronim shërbimin te

Klaudina Kuçi: Çmimet e librave, të kripura. Literatura, me gabime drejtshkrimore

Studentët: Tarifat "ulëritëse" në universitete, të papërballeshme për xhepat tanë

"Nëse nuk e paguajmë në kohë, nuk futemi në provime"

Jo pak herë, studentët e universiteteve shqiptare kanë protestuar mbi tarifën e papërballeshme të vitit akademik, por ende nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret për lehtësimin e xhepat të rinjve. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", studentja e UT-së, Klaudina Kuçi tregon se nëse nuk paguajmë në kohë tarifën e kripur, përjashtohen automatikisht nga provimi. Më tej ajo shton se kosto e librave ndonjëherë kalon edhe vetë tarifën e një viti shkollor, madje thekson se ka dhe raste të tilla ku shitja e librit bëhet dhe brenda auditorëve, e profesorët mban një listë dhe shënon studentët që blejnë librin dhe u bën presion pjesës tjetër. Një tjetër problematikë e ngritur nga studentja është edhe literatura plot me gabime drejtshkrimore, pa shtëpi botuese dhe ISBN-në përkatëse. Ka dhe raste të tilla ku shitja e librit bëhet dhe brenda auditorëve, ku profesorët mban një listë dhe shënon studentët që blejnë librin.

PRESIONI

Kosto, e cila ndonjëherë kalon dhe vetë tarifën e një viti shkollor. Çmimet e librave sigurisht janë të kripura, po sikur të mos mjaftonte kjo, ne na duhet të shfletojmë literaturë me gabime drejtshkrimore, pa shtëpi botuese dhe ISBN-në përkatëse. Ka dhe raste të tilla ku shitja e librit bëhet dhe brenda auditorëve, ku profesorët mban një listë dhe shënon studentët që blejnë librin.



Klaudina Kuçi gjatë një proteste

PROBLEMATIKAT

Aspak! Ne vazhdojmë që të paguajmë për listë notash, auditorët i kemi pa karrige, një pjesë e mirë shkruajnë akoma në dërrasë të zezë me shumës, tualetet janë në gjendje të mjerueshme po ashtu, nuk kemi asnjë mundësi të aksesojmë fotokopjen e fakultetit, pasi nuk është në shërbim të studentëve dhe bibliotekat nuk kanë literaturat e nevojshme që u korrespondojnë viteve tona të studimeve.

Punë), ose të jesh i/e verbër/ tetraplegjik/ paraplegjik, nërin nga prindërit ta kesh patur të përndjekur politik, ose të kesh statusin e jetimit etj. Dokumentacioni që duhet të sjellësh për të qenë përfutues është i pafundëm (Vërtetimi konfirmimi nga ministria përkatëse; vërtetimi studentit; fotokopje e kartës së identitetit, certifikatë familjare, vërtetimi origjinal nga njësia e vetëqeverisjes vendore për masën e pagesës së paafëtisë që merr studentit; etj) Afati është shumë i shkurtër ndaj dhe studentit e ka të vështirë të sigurojë gjithë këtë dokumentacion, në një kohë kaq të kufizuara.

Si rezultojnë këto tarifa krahasuar me vendet e rajonit dhe më gjerë?

Me një nivel ekonomie të ulët, ku rroga mesatare nuk i kalon 250 mijë lekë të vjetra në muaj, sigurisht që këto tarifa janë shumë të larta. Tarifat janë absurde, pavarësisht standardeve e kualitetit të fakultetit ku bëjmë pjesë. Në vende të tilla si Greqia, Franca, Sllovenia, Finlanda etj., përveçse gjejmë

universitete me tarifë 0, ato ndjekin dhe politika të posaçme për t'u lehtësuar jetesën studentëve.

Sa të përballeshme janë për xhepat e studentëve shqiptarë tarifën e universitetit?

Të qenit student është kosto më vete, nëse vendos të vazhdash studimet e larta, duhet të bësh disa llogari më vete si: nëse do kesh mundësi të përballosh tarifën ulëritëse, nëse do mundesh të paguash qiranë, të ushqehesh, të vishesh etj. Një student në Shqipëri nuk mund ta gëzojë plotësisht statusin e studentit. Ai si fillim ka statusin e të punësuarit, ku gjysmën e ditës i duhet të shërbejë për llogari të dikujt tjetër, e gjysmën tjetër i duhet të frekuentojë leksionet e seminarit. Praktikisht atij nuk i ngellet as kohë të lexojë, studiojë e as të punojë për ndonjë detyrë a projekt që mund t'i jepet.

Po çmimet e librave si paraqiten? A ka pasur raste kur pedagogët kanë detyruar studentët të blejnë tekste, autorë të të cilëve janë vetë pedagogët?

Përveç tarifës së universitetit, studentit i duhet të mendojë dhe koston e librave. Kosto, e cila ndonjëherë kalon dhe vetë tarifën e një viti shkollor. Çmimet e librave sigurisht janë të kripura, po sikur të mos mjaftonte kjo, ne na duhet të shfletojmë literaturë me gabime drejtshkrimore, pa shtëpi botuese dhe ISBN-në përkatëse. Ka dhe raste të tilla ku shitja e librit bëhet dhe brenda auditorëve, ku profesorët mban një listë dhe shënon studentët që blejnë librin, dhe u bën thirrje njëkohësisht studentëve të tjerë që ende nuk e kanë blerë ta bëjnë sa më shpejt në mënyrë që të mos penalizohen duke mos u futur në provim. Për studentët që nuk i kanë mundësitë financiare për të blerë libra me çmime kaq të larta, duhet të sigurohet një numër kopjesh i mjaftueshëm në bibliotekën përkatëse të fakultetit, ku të kenë mundësi të lexojnë e studiojnë.

Sa shkon kosto totale për një student gjatë një viti, duke përfshirë edhe kostot e studimit dhe të jetesës?

Një studenti i duhet të paguajë tarifën 400 mijë lekë të vjetra, i duhet të paguajë abonenë e autobusit 16 mijë lekë të vjetra në muaj (sepse aboneja e studentit qëndron në raportin 2000 abone për 20.000 studentë dhe vlen vetëm për qytetin studentit), i duhet të harxhojë për libra vetëm në një vit akademik mesatarisht 250 mijë lekë të vjetra, i duhet të ushqehet, të veshmbathet, të paguajë qira, ujë, drita etj. Kostoja vjetore arrin diku te 3-4 milionë lekë të vjetra. Në kushtet ku jemi dhe familjet nga ku vijnë, këto kosto janë të ekzagjeruara dhe të papërballeshme.

Kushtet në universitete a i justifikojnë ndopak tarifën që paguajnë studentët?

Aspak! Ne vazhdojmë që të paguajmë për listë notash, auditorët i kemi pa karrige, një pjesë e mirë shkruajnë akoma në dërrasë të zezë me shumës, tualetet janë në gjendje të mjerueshme po ashtu, nuk kemi asnjë mundësi të aksesojmë fotokopjen e fakultetit pasi nuk është në shërbim të studentëve dhe

bibliotekat nuk kanë literaturat e nevojshme që i korrespondojnë viteve tona të studimeve. Atëherë, ku shkojnë lekët tona?

A do të vazhdoni të kërkoni ulje tarifash dhe cilat do të jenë aksionet e radhës?

Qëllimi ynë kryesor është që të arrijmë të kemi arsim publik falas për të gjithë, ku studenti nuk duhet të peshohet nga xhepi, por nga merita e aftësia që ka. Ne duam një universitet dinjitoz e me studentë seriozë, ku pas viteve të shkollimit të mund të punësohen në profesion. Një student duhet të jetë vetëm student, as kamerier dhe as të çirret në call-centre për të fituar lekë e shkollimit, ndërkohë që duhet të jetë mbi libra duke studiuar. Me lëvizjen "Për Universitetin" do të vazhdojmë veprimtarinë tonë, me ndërgjegjësim, tryeza diskutuese së bashku me trupën akademike, dhe protesta derisa të shohim që do të ketë vërtet ndryshim. Lufta për arsim është e gjatë dhe ne do të jemi të organizuar. Përpjekja vazhdon!

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 8 / 58 + 1 - 4, e llojit 'Apartament', volumi 3, faqe 188, zona kadastrale 8370, me sipërfaqe totale 75 m², në bashkëpronësi të ENGJELL LUAN TOPORE dhe NATASHA LUMAN TOPORE, me adresë: Rruga "Th. Ziko", Pallati 65 / 3, Tiranë.

ÇMIMI 36.350 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 101 / 8, "Truall + Ndërtesë", ndodhur në zonën kadastrale 3096, volum 8, faqe 115, me sipërfaqe 3.200 m², nga të cilat ndërtesa ka sipërfaqe 166 m², në bashkëpronësi të YAHIA Muhamed Zakaria FARWATI dhe BRIXHILDA Batfaj FARWATI, me adresë: Qerekë, KRUIJE.

ÇMIMI 114.508 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria e paluajtshme kolateral të llojit "Pyll + Kullotë", me sipërfaqe totale 190.000 m², zona kadastrale 3028, me adresë POROVLORE, në pronësi të hipotekuesit z. FATION UKA.

ÇMIMI 1.149.120 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .


REPUBLICA E SHQIPËRISË
GYKATAKUSHTETUESE
KOLEGJII POSAÇËM I APËLIMIT
RISHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelitimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit" rishpall vendin vakant për pozicionin:

"Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun

KËRKESA TË POSAÇËM:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip - Anglisht - Shqip;
- Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

KUSHTET TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.


Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 nëntor deri më 21 nëntor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 21 nëntor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 12 nëntor deri më 21 nëntor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) origjinal ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislativës në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Epurimi Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njëjësura me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.


TENDER NOTIFICATION
FOR CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I
RECONSTRUCTION OF TAXIWAYS B, W AND W2
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for reconstruction of TAXIWAYS B, W AND W2.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist of: demolition of existing pavement taxiway structures, soil removal and excavations, drainage works, full construction of taxiways, reconstruction of taxiways, airfield lighting and all required installation and connection works.

To participate in this process interested parties will need to retrieve the Invitation to Tender and Confidentially Commitment Document together with the respective forms, which can be retrieved at Tirana International Airport premises, Administration Building, Rinas, until 23 of November 2018.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I"


The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 December 2018.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvjoka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com


REPUBLICA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
NJOFTIM – SHPALLJE

PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E "VAKANCËS SË PARAKOHSHME" TË KRUIAR PËR VENDIM GJYQAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, neneve 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/d pikat 2, 96 pika 4 shtojnë "c", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 9, datë 24.10.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. 380/4 prot, datë 29.10.2018, me cilësinë e organit të emërtësës, me qëllim plotësimin e "Vakancës së parakohshme", të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, dhe me cilësinë e organit të emërtësës me Dekretin nr. 10946, datë 09.11.2018, ka miratuar;

- Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e "Vakancës së parakohshme" të krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtarës Znj. **Altina Xhoxhaj**, sipas vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.

Presidenti i Republikës fton:

Cdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurrimit të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës;

- Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefon/emails);
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqëruar nëpërmjet të cilit vërteton përbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Listë të dokumentacionit të dorëzuar, të firmosur nga aplikanti.

Për lehtësimin e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, me postë gjëni të botuar përmblajen e nenit 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese,

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesor ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një

veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

Ligji nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 7/a

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

- Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përbush këto kushte:
 - të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
 - të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit nga data e kandidimit;
 - të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale;
 - të mos jetë larguar nga detyra për shkak disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.
- Kandidati që përbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:
 - të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
 - të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
 - të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.
- Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:
 - vjetërsisë në profesion;
 - përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë;
 - kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
 - treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
 - ecunisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlerhme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
 - informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.
- Organet e emërtësës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimit e barazisë gjinore. Kërkesa dhe dokumentat shoqëruar mund të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejtë në ambientet e Institucionit të Presidentit të Republikës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Biv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 26 nëntor 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik, dhe menjëherë dojet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e emërimit e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:
Numri telefonit: 042389898

Ministria e Financave publikon emrat e personave që marrin këstin e tretë të dëmshpërblimit, pjesa e V

5.700 të përndjekurit që marrin kompensimin

Tabela me çdo dokument që mungon në secilën dosje të trashëgimtarëve

Rreth 5.700 trashëgimtarë të ish-dënuarve politikë që presin të marrin këstin e tretë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike dhe nga Ministria e Financave. Bëhet fjalë për përfitues të kategorisë jo parësore që do të trajtohen me dëmshpërbllim, por që sipas këtij dikastri duhet të dorëzojnë dokumentet. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. Të gjithë personat kanë afati deri më



9 shkurt 2019 për të plotësuar dosjen.
DOKUMENTET
Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmetë të vetme në krahasim me dëshminë e

trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet mededmos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq.

EMRAT ME PERFITUESIT E KOMPENSIMIT TE TE PERNDJEKURVE

NR. DOSJES	EMER	MBEMER	EMER	ATENSA	MEBEMER	KOPJETE LETER SHOPTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIE BANKARE	CERTIFIKATE VOTDJE	CERTIFIKATE E TRINGJET FAMILJAR	DESIMI TRASHGIMTAR	PRO-SKRIE	CERTIFIKATE GJENDJA CIVILE
1388	VESSEL	RUSHAJ	EDUARD VESSEL	RUSHAJ			X	V	V	V		
			FLORINDA VESSEL	FRANJA			X					P
			KATERINA VESSEL	RUSHAJ		X	X					P
			NATALIA VESSEL	RUSHAJ			X					P
7860	IMAN	TAMISHI	BELIL					V	V	X		
			BERDE IMAN	TARUSHI							P	
			AGIM IMAN	TARUSHI							P	
			RIFA IMAN	MEMETI							P	
			TOMIR IMAN	TARUSHI							P	
			BLERK IMAN	TARUSHI			X	X			V	
2582	ALI	DUKA	ZENEL HADRI	DUKA			X	V	V	V		
			NIJRE HADRI	DUKA			X				V	V
3843	NAZAR	SELIMULLARI	RAPUSH			X	X					P
9970	GEZM	KADESHA	NIJMAL GEZM	KADESHA			X	V	V	V		
			DITUNI GEZM	KADESHA			X					P
			EGNATIA GEZM	KADESHA			X					P
361	KRISTO	QEHAFAJ	MIRAT				V	V	V	V		
			SFOJTE ALI	QAHAFI			V	V	V	V		
			MIRREJA KRISTO	QAHAFI		V	V				P	
			MIRAT KRISTO	QAHAFI		V	V				P	
			JANI KRISTO	QAHAFI		V	V				P	
			IRMA KRISTO	SINANI		V	V				P	
2573	BEOR	QOQJA	SABIK				V	V	V	V		
			BLUKRIJE BEOR	LEKAI		V	V				P	
			FATOS BEOR	QOQJA		V	V				P	
			SABIK BEOR	QOQJA		V	V				P	
			SEMHA BEOR	BONJAKU		V	V				P	
			SHOPE BEOR	METE		V	V				P	
6618	EMRILLA	YMERAJ	YMER				V	V	V	V		
			RUSHKE HAMI	HYMERAJ		V	V	V	X			
			RAZIKI EMRILLA	HYMERAJ							P	
			RAZORE EMRILLA	LEKAI							P	
			KALEM EMRILLA	HYMERAJ							P	
			SHIRO EMRILLA	HYMERAJ							P	
			ADJE EMRILLA	HYMERAJ							P	
2434	ELMAZ	KALLAPOQHI	ABDIN	KALLAPOQHI		V	V	V	V	V		
			TAIBE ABDE	KALLAPOQHI		V	V	V	V	V		
			SABETE ELMAZ	KALLAPOQHI		V	V	V	V	V		
			ABDIRIN ELMAZ	KALLAPOQHI		V	V	X	X			
			ASTRI ELMAZ	KALLAPOQHI		V	V	X	X			
			RAKIP ELMAZ	KALLAPOQHI		V	V	X	X			
4972	SHEFOET	HOXHA	BEOR				V	V	V	V		
			TUSIB JONUZ	HOXHA	X						P	
			ANDREA SHEFOET	HOXHA							P	
			HAMIDE SHEFOET	BALLA							P	
			IRJGA SHEFOET	HOXHA							P	
			NIJRE SHEFOET	RASANI							P	
			OLJIM SHEFOET	BRASHA	X						P	
			MHMAL SHEFOET	HOXHA							P	
12151	CAKE	HYSAJ	ALI				V	X	V	V		
			ALBERT ISMAIL	ISMAILI		X	X					
5402	MYSLYM	RINSHI	ABDULLA				V	V	V	V		
			VEZNI LEMAN	RINSHI	X						P	
			ARBAN MYSLYM	RINSHI	X						P	
			EMILIANO MYSLYM	RINSHI		X					P	
			ABDULLA MYSLYM	RINSHI		X					P	
9426	ISMAEL	LACT	MHMAL				V	V	V	V		
			AFERDITA ISMAIL	MOCKA	X	X	X					
			AFRIM ISMAIL	LACT		X	X					
8596	VAIT	MESEREJA	ISLAM				V	V	V	V		
			ADNAND VAIT	MESEREJA			V	V	V	V		
			SHPETIM VAIT	MESEREJA		V	V					
10993	MEHDI	MUDA	ELISABETA	MEHDI		V	V	V	V	V		
			XHINO MEHDI	MUDA		V	X					
			ZAMBRA MEHDI	DAUTI		V	X					
			VAHIDE MEHDI	MUDA		V	X					
9666	HAMIT	HALILI	BERJIE	HALILI		X	V	V	V	V		
			KAK HAMIT	HALILI		X	V	V	V	V		
			SERHIE HAMIT	HALILI		V	X					
			SEVET HAMIT	HALILI		X	X					
9975	RENHEP	TAJARI	AFERDITA	RENHEP			X				P	
			FIDAJET ZYFER	TAJARI	X		X				P	
			KUTIM RENHEP	TAJARI	X	X					P	
			LULETA RENHEP	TAJARI	X						P	
			SUZANA RENHEP	TAJARI	X						P	
			VELI RENHEP	TAJARI	X						P	

Intervista

Psikologia: Mashkulli ideal, prezent jo vetëm fizikisht, por edhe emocionalisht

Orjola Plaku:

Ja cili është rregulli i një martese të suksesshme

"Devotshmëria, përkushtimi dhe respekti sjellin lumturi në bashkëjetesë"

Egla Xhemali

Thedhësh dritë mbi problematikat sociale që prekin përditshmërinë e kryesisht ato që kanë lidhje me fëmijët apo dhe raportet në çift është paksa e vështirë, megjithatë ajo ka vendosur të na shpjegojë thjeshtë atë që në pamje të parë na duket e ndërlikuar. Orjola Plaku rrëfen për "Gazeta shqiptare" mënyrën se si duhet të sillen prindërit me fëmijët e vegjël kur ata hasin ndonjë pakenaqsë dhe nuk e tregojnë atë, për mënyrën se si mund t'i tregohet një fëmije për ndryshimet që pëson gjatë pubertetit, si dhe për rregullin e pashkruar të një martese të suksesshme. Sipas psikologes, çelësi magjik ndaj shqetësimeve të fëmijëve është komunikimi me prindërit. Moshë e tyre ka nevojë të ndjej suport emocional. Një tjetër çështje që Plaku i kushton rëndësi është ajo e pedofilisë. Edhe këtu prindi duhet të jetë njaft i kujdesshëm, duke e këshilluar fëmijën të jetë vigjilent



ndaj ftesave që i vijnë nga të panjohurit. Më tej, Orjola na pohon se rregulli i pashkruar i një martese të suksesshme është ndërveprimi i çiftit, kuptueshëria, si dhe marrja e vendimeve së bashku.

Si duhet të sillen prindë-

rit me fëmijët që nuk tregojnë për ndonjë shqetësim që kanë në kopsht apo qerthe?

Prindërit janë dy figurat më të rëndësishme, të cilët duhet të zhvillojnë ndenja sigurie dhe marrëdhënie me baza të shëndosha. Kjo do të

thotë që komunikimi prind-fëmijë është çelësi për të kuptuar se çfarë po ndodh me fëmijën. Në fakt, një prind duhet të shqetësohet në momentet kur fëmija nuk ndërvepron apo ka ndryshuar sjelljen. Fëmija ka nevojë të ndjejë se ka dikë që



Prindërit janë dy figurat më të rëndësishme, të cilët duhet të zhvillojnë ndenja sigurie dhe marrëdhënie me baza të shëndosha. Kjo do të thotë që komunikimi prind-fëmijë është çelësi për të kuptuar se çfarë po ndodh me fëmijën.

është që mos të flasë me të panjohurit, të mos u përgjigjet ftesave të tyre etj.

Mënyra më e mirë për t'ia shpjeguar një fëmije ndryshimet që pëson në pubertet?

Prindi duhet të flasë dhe të fokusohet se këto janë procese natyrale të rritjes dhe janë të stimuluar si rezultat i hormoneve. Fëmija ka nevojë t'i shpjegohet me argumente dhe të përgatitet psikologjikisht për të pranuar ndryshimet trupore.

Pika më e dobët e një babai gjatë edukimit të fëmijës?

Çdo prind ka anët e forta dhe dobëta gjatë prindërimit, por kjo mbetet edhe çështje personaliteti, zhvillimi individual, konteksti ku është rritur. Ka shumë faktorë që ndikojnë, por mund të them se çdo prind duhet të bëjë një analizë me veten gjatë prindërimit. Por, nuk dua ta përjashtoj që ka modele të tjera shumë më të mira se nëna.

Mashkulli ideal, kur gruaja është shtatzënë?

Mashkulli ideal kur partnerja është shtatzënë është ai që ka aftësinë të kuptojë dhe t'i përgjigjet në mënyrë adekuate partneres. Të jetë prezent jo vetëm fizikisht, por edhe emocionalisht.

Rregulli i pashkruar për një martesë të suksesshme?

Rregulli i pashkruar që një martesë të jetë e suksesshme, të flasësh teorikisht është pjesa më e thjeshtë, por praktikisht duket e vështirë. Unë mendoj devotshmëria, përkushtimi dhe respekti përbejnë elemente të rëndësishme post-komunikimit në çift. Mendoj se këto mund ta bëjnë një bashkëjetesë të suksesshme, të dëgjuarit njëri-tjetrit dhe vendimmarrje nga të dyja palët. Do të thotë të jesh sa me fleksibël, të rrisësh nivelin e kuptueshmërisë, duke zhvilluar edhe tolerancën me partnerin.

e suporton emocionalisht. Prindi duhet të fokusohet në nevojat e fëmijës, të kuptojë se çfarë po e shqetëson fëmijën? Ta ftojë të flasë për kopshtin, lojërat, shokët dhe shfaqjen apo edukatoren. Kjo do të ndikojë pozitivisht në psikologjinë e fëmijës, por nëse fëmija nuk reagon pozitivisht ndaj përpjekjeve tuaja, duhet të bisedoni me një psikolog zhvillimi, që ndërhyrja e specialistit të jetë sa më e hershme, me qëllim të zbuten vështirësitë që paraqet.


Çfarë duhet të bëjmë për t'i mbrojtur fëmijët nga pedofilia?

Duhet t'i mësojmë se sa e rëndësishme është të ruajmë distancat fizike me të tjerët. T'i flasim duke përshtatur gjuhën me moshën e fëmijës. Prindërit duhet të përdorin forma të disiplinimit pozitiv me fëmijën, që të lehtësojnë komunikimin me ta. Fëmijës i duhet shpjeguar se si duhet të reagojë dhe ku duhet ta referojë shqetësimin që ka. Vëmendja prindërore është tepër e rëndësishme dhe një mekanizëm i mirë për të kuptuar se çfarë po ndodh me fëmijën. Fëmija duhet të mësohet se sa e rëndësishme

Enca bën ndryshimin e papritur, shihni si duket këngëtarja



Arritët ta njihnit Encën? Pasi sqaroi përfundimisht për publikun për konfliktin me Noizyn, bukurshja ka vendosur të bëjë ndryshimin e papritur. Gjatë një interviste për emisionin "NIN", këngëtarja shqiptare tregoi se nuk e cilëson Noizyn si armik, por nga ana tjetër thotë që nuk mund të bashkëpunojë më me të. Por pas kësaj deklarate që bëri bujë në mediat rozë, Enca ka bërë ndryshimin drastik në pamje. Ajo njihet për eksperimentet që bën me pamjen e saj dhe së fundmi Enca ka publikuar disa foto në rrjetin social "Instagram", në të cilën shfaqet tërësisht bionde.



Oriola Marashi është një ndër vajzat më provokuese të "show bizz"-it shqiptar. Anëtarën e grupit OTR e kemi parë gjithmonë me veshje ekstravagante dhe mjaft seksi, duke i lënë të gjithë me gojë hapur. Ajo është shumë aktive në rrjetet sociale, ku poston foto e video të ndryshme nga përditshmëria dhe shpeshherë tërheq vëmendjen e të gjithëve me pozat e saj provokuese. Oriola ka postuar një foto në "Instagram", ku shihet tejet e nxehtë, bionde dhe tërësisht e zhveshur. "Kam një të dashur të quajtur muzikë dhe së shpejti do kemi një fëmijë", shkruan Oriola dhe ne mezi po e presim që fëmija e saj e parë të vijë në jetë sa më parë, pasi është pak por e sigurt, do bëhet hit menjëherë.

Oriola e dashuruar dhe me fëmijë? Modelja flet për herë të parë

Era Istrefi është një nga këngëtares me të dashura për publikun shqiptar dhe jo vetëm. Ajo deri tani ka shumë projekte që bota po i dëgjon si "Bonbon", "Redrum", "I love You", "Live it up", "Origami", "Oh God" dhe së fundmi dy bashkëpunime mjaft të fuqishme, "Purpose" me "Jonas Blue" dhe "Anything More" me Steve Aoki. Por, ka edhe projekte të tjera që Era po punon, thjesht po pret kohën e duhur për t'i publikuar. Siç duket, Era tashmë po punon sërish në studio dhe këtë herë me një tjetër yll botëror, siç është Yellow Claw. Një ndër DJ më të famshëm në botë e ka bërë të ditur këtë gjë, duke postuar një foto ku shihet Eyelar dhe Era Istrefi. Eyelar shkruan se ata po punojnë shumë seriozisht për tekstet. Ne mezi po i presim produksionet e Erës!



Era Istrefi paralajmëron suksesin e radhës

Skandali në Shtëpinë e Bardhë, pas 20 vitesh zbulohen detajet

Monica Lewinsky flet për aferën seksuale me Bill Clinton

Ish-praktikantja tregon të pathënat në dokumentar

Edhe sikur të pyetjet edhe ditët e sotme lidhur me aferën e 23 viteve më parë, ish-presidenti i SHBA-së, Bill Clinton thotë se do të përgjigjej edhe sot njësoj si në vitin 1998 në lidhje me marrëdhënien e tij me Monica Lewinsky-n. "Nëse faktet do të ishin të njëjtat, nuk do të përgjigjesha ndryshe", tha ai në një intervistë në NBC. Ndërsa një sërë rastesh abuzimi seksual kanë dalë në dritë në kuadër të lëvizjes #MeToo, Clinton u pyet nëse skandali që e përfshiu atë vetë 20 vjet më parë u menaxhua me sukses. "Mendoj se kam bërë gjënë e duhur", tha ai në lidhje me këtë. Clinton në atë kohë u hetua për dyshimet se i kishte gënjyer hetuesit në dëshminë e parë mbi skandalin seksual që përfshiu Shtëpinë e Bardhë. Lëvizja për shkarkimin e Clintonit u nis nga republikanët, çka e bëri Clintonin presidentin e dytë në historinë e Amerikës që vije në një situatë të tillë. Megjithatë, ai mbeti në pushtet deri në vitin 2001. Clinton tha se nuk i ka kërkuar kurë personalisht falje zonjës Lewinsky. Por shtoi se e ka bërë këtë në disa raste publikisht. Ish-praktikantja e Shtëpisë së Bardhë ka pranuar gjithnjë se marrëdhënia me presidentin ka qenë konsensuale, por e ka quajtur "abuzim me pushtetin" nga ana e tij. Lewinsky është shprehur në vitin 2014 se "abuzimi" erdhi kur gjërat dolën në dritë dhe asaj iu desh të sakrifikohej në mënyrë që presidenti të mos humbte pushtetin. Lajmet për marrëdhënien e presidentit Clinton me praktikantën Monica Lewinsky dominuan axhendën politike të fundit të viteve '90. Fillimisht, Clinton e mohoi se kishte pasur marrëdhënie seksuale me Lewinsky-n, por më pas u detyrua të pranonte "kontaktet fizike intime dhe të papërshtatshme". De-



Monica Lewinsky

klarata e tij fillestare: "Unë nuk kam pasur marrëdhënie seksuale me atë grua" ka mbetur në memorien kolektive si një nga gënjeshtrat më të mëdha të thëna nga një njeri i politikës. Ndërkaq Monica Lewinsky ka folur edhe herë të tjera për aferën seksuale që ka pasur me ish-Presidentin amerikan Bill Clinton në vitin 1995. Por për herë të parë pas më shumë se dy dekadash, ajo ka rrëfyer në një dokumentar të përbërë nga 6 seri lidhur jashtë martesore që Presidenti Clinton kishte me të.

Seritë do të transmetohen nga data 18 nëntor; megjithatë Monica Lewinsky ka ndarë paraprakisht disa detaje. Ajo flet për marrëdhënie seksuale që pati me Bill Clinton në Zyrën Ovale të Shtëpisë së Bardhë. Monica Lewinsky, në atë kohë 22 vjeç, kujton takimin në zyrën e Presidentit në vitin 1997. "Shkua në tualet për të pasur më shumë intimitet", thotë 45-vjeçarja, duke shtuar se në fund të dy u përqaftuan. Pasi doli nga tualeti, ajo zbuloi se fustani i saj i zi kishte një njollë. Filli-

MONICA LEWINSKY

"Pastaj u futëm në banjë dhe ishim më intimë. Më kushtoi vëmendje dhe më pas u ktheva, deri në atë pikë sa ai gjithmonë ndalonte përpara se të përfundonte pjesën. Pak a shumë u ngrita dhe e lashë të kalonte fazën dhe ai më në fund tha OK. Më pas e përqafova edhe ai më përqafoi. Dhe u largova. Dolëm për darkë atë natë. Askush nuk më tha: Hej, shko në banjë pasi ke atë gjënë në fustan", ka thënë Lewinsky.

njollën e famshme në fustanin blu. Lewinsky thotë se nuk e dinte se kishte njollë në fustan, madje në një pikë kishte menduar se mos ishte salcë spinaqi. Ajo pranoi se njollën në fustan e mori pasi performoi aktin seksual me presidentin në banjën e Zyrës Ovale, pak pasi ai i kishte dhuruar një karficë dhe një libër. Lewinsky zbuloi se u fut në Zyrën Ovale me presidentin dhe sekretarin e tij, por ky i fundit u zhduk menjëherë. Sekretari hyri vetëm që të dy të mos shiheshin vetëm, sepse kishte dy vite që përfillej historia. "Pastaj u futëm në banjë dhe ishim më intimë. Më kushtoi vëmendje dhe më pas u ktheva, deri në atë pikë sa ai gjithmonë ndalonte përpara se të përfundonte pjesën. Pak a shumë u ngrita dhe e lashë të kalonte fazën dhe ai më në fund tha OK. Më pas e përqafova, edhe ai më përqafoi. Dhe u largova". Me të njëjtin fustan, ajo doli për darkë. "Dolëm për darkë atë natë. Askush nuk më tha: Hej, shko në banjë pasi ke atë gjënë në fustan". Pas shpërthimit të këtij skandali, ish-Presidenti amerikan Bill Clinton u detyrua ta pranonte aferën seksuale, duke thënë: "Kam pasur një marrëdhënie me znj. Lewinsky që nuk ishte e përshtatshme".

SHKURT

Vrau në mënyrë makabre familjen, vrasësi pranon akuzat
33-vjeçari amerikan aku- zohet për 9 vrasje, 3 prej të cilave makabre. Christopher Watts ka pranuar se ka vrarë dy vajzat e vogla 3 dhe 4 vjeç, si dhe bashkëshorten Shannan 15 javësh shtatzënë. Rrezikonte dënimin me vdekje, por gjykatësit në Kolorado e dënuan me burgim të përjetshëm pasi në sallën e gjyqit pranoi krimet pas muajsh hetime. Krimi më i fundit i tij ishte vrasja e gruas dhe vajzave, më 4 gusht në shtëpinë e tyre në Denver. Pasi i vrau, për shkak të një zënke me bashkëshorten, siç pretendon Watts, trupat e tyre i gpropoi. Trupat e tyre u gjetën rreth dy javë më vonë, pasi hetuesit gjetën prova për ta arrestuar më 15 gusht. Deri në atë kohë ai kishte dalë shpesh herë në media, duke u hequr si i pafajshëm, duke pretenduar se bashkëshortja i kishte ikur nga shtëpia. "S'ia kam idenë ku kanë shkuar. Fëmijët, e qeshura e tyre janë jeta ime. Shpresoj që ajo të jetë në një vend të sigurt. Nëse është zhdukur, dua që ajo të kthehet bashkë me fëmijët", kishte deklaruar në kardia Watts. Motivet e krimit janë ende të paqarta. Hetuesit ende nuk kanë dhënë një motiv zyrtar. Por nuk përjashtojmë mundësinë që autori të ketë probleme psikike.

Kalifornia përfshihet nga flakët gjigante
Mes flakëve gjigande, mijëra banorë të Kalifornisë largohen të tmerur çdo natë nga shtëpitë e tyre për t'u shpëtuar flakëve që zgjerojnë shtrirjen e tyre me shpejtësi. Ekipet e emergjencës janë në luftë me kohën për të penguar bllokimin e rrugëve kombëtare për të lehtësuar evakuimin e banorëve. Ateje u flakët janë shuar pasi kanë shkruar gjithçka, po kërkohet për trupa e viktimash. Shpesh herë është i pamundur dallimi i mbetjeve njerëzore dhe duhet ndihma e qenve nuhatës. Bilanci i përkohshëm është 44 të vdekur, por shumë i lartë është numri i të zhdukurve, mbi 200 çka tregon tendencën e rritjes së numrit të viktimave. Hapësira pyjore e djegur po arrin deri në 100 mijë hektarë, teksa flakët përhapen me një shpejtësi prej 30 fushash futbolli në minutë. Në veri dhe në jug të shtetit federal janë aktive 2 vatra të mëdha. Pikërisht erërat e forta dhe shkëndijat në shtyllat elektrike mendohej të kenë qenë shkaktarë të një prej tragjediave më të rëndë në historinë kaliforniane.

Dalja nga BE, Theresa May përballë skeptikëve

Plani për 2019, ministrat euroskeptikë: Marrëveshja e shndërron Britaninë në vasale të BE-së

Vijojnë diskutimet e Britanisë së Madhe me pjesën tjetër të BE-së ku pas daljes nga kjo e fundit do të vendoset një marrëveshje përfundimtare se si do të jenë marrëdhëniet me tyre. Kryeministrja Theresa May mbledhi kabinetin qeveritar për të miratuar planin që përcakton marrëdhënien me Brukselin pas shkëputjes nga Bashkimi Europian në 2019-ën. Mbledhja shtyhej prej ditësh, pasi plani kundërshtohet ashpër nga disa ministra euroskeptikë. Në orët e vona të së martës Londra dhe Brukseli gjetën gjuhën e përbashkët pas disa muajsh mosmarrëveshjes. Por ish-ministri i jashtëm Boris Johnson thotë se marrëveshja e



Theresa May

shndërron Britaninë në vasale të BE-së. Boris Johnson, ish-ministër i Jashtëm: Ne do të qëndrojmë në unionin doganor. Do t'u nënshtrohemi rregullave të tregut të përbashkët. Dhe kjo nënkupton gjendje

vasaliteti. Për të parën herë në 1 mijë vjet, ky parlament nuk do të ketë të drejtën e fjalës për ligjet që qeverisin vendin. Sipas marrëveshjes, mes Irlandës së Veriut dhe Republikës së Irlandës nuk do të ketë kontrolle kufitare.

SAMMY WILSON

"Pa marrëveshje është më mirë se me një marrëveshje të keqe. Marrëveshja e keqe është ajo do shpërbëjë Britaninë e Madhe, që na mban ne të lidhur me Bashkimin Europian dhe na shkëput nga Britania e Madhe", ka thënë deputeti i unionistëve irlandezë, Wilson.

Do të ruhet i njëjti status si në Bashkimin Europian, të paktën deri në vitin 2020. Por për deputetët që duan të qëndrojnë të bashkuar me Britaninë, kjo do të thotë shpërbërje e vendit. Sammy Wilson, Deputet i Unionistëve Irlandezë: Pa marrëveshje është më mirë se me një marrëveshje të keqe. Marrëveshja e keqe është ajo do shpërbëjë Britaninë e Madhe, që na mban ne të lidhur me Bashkimin Europian dhe na shkëput nga Britania e Madhe", ka thënë deputeti i unionistëve irlandezë, Wilson.

Prangosen ish-ministri i Transportit dhe ish-sekretari i qeverisë

Pas arratisjes së Gruevskit, arrestohen dy të akuzuarit për çështjen "Titanik"

Ish-ministri i Transportit të Maqedonisë Mile Janakieski dhe ish-sekretari i qeverisë Kiril Bozhinovski janë arrestuar ditën e martë në mbrëmje. Ata janë vënë në pranga me kërkesë të prokurorisë speciale dhe vendim të Gjykatës Penale e më pas janë dërguar në burgun e Shutkës. Arrestimi ka ardhur si rezultat i arratisjes së ish-kryeministrit maqedonas Gruevskit dhe për të shmangur një largim të tyre policia i ka çuar pas hekurave. Të dy të arrestuarit janë nën hetim për çështjen "Tali" dhe janë akuzuar në disa raste të tjera që përfshirë "Titanikun", për të cilin është caktuar një seancë dëgjimore në ora 9.30. Mile Janakies-



Ish-ministri i Transporteve, Mile Janakieski

ki tha se nuk e përkrah ikjen e Gruevskit. Gjykata speciale e Shkupit caktoi 30 ditë paraburgim për dy të arrestuarit. Arrestimet u kryen në orën 05:00 të mëngjesit të së mërkurës, pas urdhër-arrestit të kërkuar nga prokurorët të cilët thanë se kishin informacione se Janakieski dhe Bozhinovski po përgatiteshin të arratiseshin, nën shembullin e ish-Kryeministrit Nikolla Gruevski. Në një deklaratë për mediat, Kryeministri Zoran Zaev kërkoi nga Hungaria ekstradimin e Gruevskit. "Kemi lëshuar urdhër-arrest ndërkombëtar dhe

kërkojmë nga Hungaria që Nikolla Gruevski të ekstradohet. Arratisja e tij tregon se ai ndihet fajtor për atë që është gjykuar". Krahas aferës korruptive 600 mijë euroshe të Mercedes-it, Gruevski rrezikon dënimin edhe për rastin "Titanik", ku të akuzuarit dyshohen se kanë ushtruar presion e u kanë dhënë rryshfet votuesve në zgjedhjet lokale të 2012-ës në Maqedoni, me qëllim manipulimin e rezultatit. Gruevski u arratis në Budapest dhe ditën e martë në një postim në "Facebook" shkruante se ka kërkuar azil në Hungaria duke qenë i dënuar me 2 vite burg nga Gjykata Penale.

Prokurorja maqedonase, optimiste: Do të ekstradohet për në Maqedoni

Nikolla Gruevski kërkoi azil, Hungaria e pranon

Vikor Orban: E strehuam për çështje sigurie



Ish-kryeministri Nikolla Gruevski

KATICA JANEVA

"Për rastin 'Tanku', ku Gruevski është dënuar me dy vite burg për shpërdorim detyre, ne nuk kërkuam paraburgim duke vlerësuar se ai vinte rregullisht në gjykatë dhe ishte deputet në Kuvend", - ka deklaruar Katica Janeva, duke shtuar se institucionet nuk duhet ta çojnë fajin te njëra-tjetra për arratisjen e tij.

QEVERIA HUNGAREZE

"Ish-kryeministri i Maqedonisë ka deklaruar arsyet për mundësimin e statusit të refugjatit në Hungari. Autoritetet hungareze do ta shqyrtojnë kërkesën e Gruevskit dhe do ta vlerësojnë në përputhje me ligjet hungareze dhe ato ndërkombëtare", - ka thënë qeveria hungareze.

ca Janeva, duke shtuar se institucionet nuk duhet ta çojnë fajin te njëra-tjetra për arratisjen e tij. Prokurorja shprehet optimiste se

Gruevski do të ekstradohet nga Hungaria, aty ku ka kërkuar azil politik dhe do të gjykohej në Maqedoni edhe për akuzat tjera. Ndërkaq

tanimë ish-kryeministri maqedonas ndodhet në Hungari ku ka kërkuar strehim politik. Përmes një deklaratë për shtyp, ministria maqedonase njoftoi se ka marrë përgjigjen e autoriteteve hungareze, të cilat pohuan se Gruevski ndodhej atje dhe se ka kërkuar azil politik. Menjëherë pas përgjigjes nga pala hungareze, Gjykata themelore e Shkupit, me kërkesë të Ministrisë së Brendshme, lëshoi urdhër-arrest ndërkombëtar për ish-kryeministrit maqedonas. Ishte vetë Gruevski që njoftoi përmes "Facebook"-ut arratisjen për në Hungari. "Ditët e fundit kam marrë një numër

të madh kërcënimesh me jetë. Unë jam në Budapest dhe kam kërkuar azil politik nga autoritetet hungareze. Gjithmonë do t'i qëndroj besnik kauzës së Maqedonisë. Asnjëherë nuk do të kthehem mbrapa!" Ish-lideri maqedonas njihet për një marrëdhënie të ngushtë me kryeministrit hungarez Viktor Orban. Ky i fundit u akuzua nga opozita në Hungari se po strehon një kriminel. Nikolla Gruevski u dënua me 2 vite burg nga Gjykata Penale e Shkupit, për abuzim me tenderët në kohën kur ishte kryeministër. Tashmë atij i mbetet si shpresë e vetme falja presidenciale nga Gjorge Ivanov.

SHKURT

Akuza ndaj Weinstein, Paz de la Huerta: Më ka përdhunuar

Akuza të reja për Harvey Weinstein për abuzim seksual. Këtë herë është artistja Paz de la Huerta që ka hapur një proces ligjor kundër ish-producentit të Hollywood-it, duke e akuzuar se ka abuzuar me të dhe e ka përdhunuar, duke i dëmtuar edhe karrierën. Faktet i përkasin vitit 2010 dhe sipas la Huertas ai e ka përdhunuar atë dy herë në New York. Më pas në 2011 në Beverly Hills ish-producenti kishte tentuar të shpërthente në seks me artisten, duke e ngacmuar edhe me telefonata. Ai, gjithmonë sipas aktore, ka luajtur një rol vendimtar në heqjen e saj nga seritë televizive të HBO. Këto janë akuza të reja për Weinstein, i cili ka edhe procese të tjera për abuzim seksual në New York.

Spanjë, piloti bën ulje të rrezikshme gjatë stuhisë

Nuk e kanë humbur qetësinë pilotët i këtij avioni, që i është dashur të bëjë ulje pavarësisht stuhisë. Në filmim shihet kabina e pilotit të një Boeing 737-800 teksa zbrit në aeroportin ndërkombëtar të Son San Juan të Palma de Maiorca, në ishullin Balear, në Spanjë. Të dy pilotët arrijnë të menaxhojnë situatën në mënyrën më të mirë, duke prekur tokën pavarësisht erës së fortë dhe shirave të fuqishëm.

Lufta në Gaza, OKB thirrje Izraelit e

Palestinës për vetëkontroll
Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, u bëri thirrje Izraelit dhe Palestinës të tregojnë vetëpërmbytje maksimale në Gaza. Farhan Haq, një nga zëdhënësit e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, në një deklaratë me shkrim tha se Guterres ka ndjekur nga afer zhvillimet e fundit në Gaza dhe u bëri thirrje të gjitha palëve të tregojnë vetëpërmbytje maksimale. Haq thotë se edhe Përfaqësuesi Special i OKB-së për Procesin e Paqes në Lindjen e Mesme, Nickolay Mladenov, po punon ngushtë me Egjiptin dhe të gjitha palët për të siguruar qetësinë. Ndërkohe bëhet e dritur se ushtria izraelite vazhdon të godasë Rripin e Gazës nën bllokadë, ndërsa grupet palestineze vazhdojnë t'u përgjigjen sulmeve izraelite me raketa. Ushtria izraelite ka njoftuar se më shumë se 300 raketa janë lëshuar nga Gaza në anën e Izraelit që nga mbrëmja e deri më tani, ku një pjesë e madhe e këtyre raketave kanë rënë në territore boshë. Gjithashtu, ushtria izraelite njoftoi se si pasojë e zjarrit të hapur nga Gaza drejt anës tjetër të kufirit u qëllua një autobus, me ç'rast avionet izraelitë nisën sulmet ajrore ndaj Gazës.

Ditën e djeshme ish-kryeministri maqedonas, Nikolla Gruevski ka dorëzuar kërkesë për azil tek autoritetet kompetente hungareze. Ishte vetë kabineti i kryeministrit hungarez, Viktor Orban që konfirmoi lajmin për mediat maqedonase. "Ish-kryeministri i Maqedonisë ka deklaruar arsyet për mundësimin e statusit të refugjatit në Hungari. Duke pasur parasysh se Gruevski ka qenë për 10 vite kryeministër dhe duke marrë në konsideratë rrethanat e sigurisë, autoritetet tona i kanë lejuar Gruevskit të dorëzojë zyrtarisht kërkesë për azil dhe e kanë dëgjuar arsyetimin e tij në zyrat e Byrosë për migrim dhe azil në Budapest. Autoritetet hungareze do ta shqyrtojnë kërkesën e Gruevskit dhe do ta vlerësojnë në përputhje me ligjet hungareze dhe ato ndërkombëtare". Ne nuk dëshirojmë të ndërhyjmë në punët e brendshme të shteteve sovraane dhe konsiderojmë se vlerësimi i kërkesës për azil për ish-kryeministritin do të shqyrtohet vetëm në aspektin juridik, theksojnë nga kabineti i Orban duke shtuar se nuk mund të ndajmë më shumë informata me opinionin lidhur me procedurën për azil të ish-kryeministrit Gruevski para se të përfundojë procedura. Ndërkaq prokurorja e PSP në Maqedoni, Katica Janeva ka deklaruar për 1TV se për çështjen "Titanik" ka kërkuar paraburgim për ish-kryeministritin Nikolla Gruevski, por se Gjykata Penale e ka refuzuar dhe ka sjellë masa tjera kujdesi, ndërsa për rastin "Tanku", nuk është kërkuar paraburgim. "Për rastin 'Tanku' ku Gruevski është dënuar me dy vite burg për shpërdorim detyre ne nuk kërkuam paraburgim duke vlerësuar se ai rregullisht vinte në gjykatë dhe ishte deputet në Kuvend", - ka deklaruar Kati-

PANAIRI

TITUJT E RINJ NË PANAIR

Nga Kadare për Pasternakun, te nobelistët e shkrimtarët shqiptarë

Fatmira Nikolli

Kur Osip Mandelstam do të ar restohej mbrëmjen e 16 majit 1934, se kish folur shumë kundër pushtetit të Stalinit, Boris Pasternak do të rendte në shtëpinë e tij, për të takuar të shoqen dhe për të kërkuar të gjenin në parti një mik që do të mund ta shpëtonte. Ndërsa përpigje të shpëtonte Mandelstamin, Pasternaku, do të shprehej për shumë të tjerë, se nuk kishte të bënte me të.

Më 13 qershor 1934, në apartamentin e shkrimtarit në rrugën Volkhonka, bie zilja e telefonit. Ai u përgjigj dhe nga ana tjetër dëgjo një sekretar t'i thoshte se do t'i kalonte në telefon, Stalinin. Fillimisht, Pasternak mendoi se ishte ndonjë mik që donte t'i bënte një lojë, nuk besonte se Stalini donte të fliste me një si ai, ndaj e mbylli telefonin. Por telefoni ra përsëri. Pak minuta më vonë, dëgjon frazën "Po ju flet Stalini".

Biseda e 84 viteve më parë, shërbën ende si një temë për të cilën ka dritëhije. Dilemat janë mbi disa prej përgjigjeve që ka dhënë atë ditë Pasternak, kur Stalini e ka pyetur për mikun e tij Mandelstam.

Nis me këtë telefonatë, një prej librave më interesantë të këtij panairi.

Është libri më i fundit i Ismail Kadaresë: "Kur sunduesit grinden". Rreth misterit të telefonimit Stalin-Pasternak. Vepra sjell një qasje mbi raportin e shkrimtarëve me diktatorët dhe në kopertinë ka imazhin e Janusit, perëndisë që sipas mitit romak, që perëndia e fillimit, kohës,

tranzicionit, dualitetit, Janusi, i përshkruar si me dy fytyra sheh njëherësh të shkuarën e të të ardhmen- ai shenjon fillimin dhe mbarimin e konfliktit, luftën dhe paqen.

Portat e një ndërtese në Romë që mbante emrin e tij, hapeshin në kohë lufte dhe mbylleshin për të shënuar ardhjen e paqes. Kadare po punon me këtë libër prej dy vitesh; mbi telefonatën e diskutuar gjatë, të një shkrimtari në ish-Bashkimin sovjetik me Stalinin - 'udhëheqësin' që dikur do e përdorte këtë telefonatë, kundër vetë shkrimtarit.

TITUJT

Ky është një prej titujve të rinj në panair. Më poshtë, 'GSh', sjell titujt e rinj nga disa shtëpi botuese që marrin pjesë në këtë event.

Shkrimtari Mehmet Kraja do të jetë në stendën e Onufrit në Panairin e Librit, të enjten në orën 11, për të promovuar dhe nënshkruar romanin e tij të ri "Pristina".

"Shënimet e Krimbit Smolinski", romani i ri nga Azem Deliu, ku Piotr Smolinski, shkrimtar i njohur polak, ftohet në një rezidençë artistësh në Kosovë ku ndeshet me mentalitetin e pasluftës, e që në disa pika, i kujton problemet e pas rënies së komunizmit në vendin e tij. Përballjet e tij me familjen, traditën, kishën, e në fund fare, me veten, e bëjnë të mbajë nofkën dëshpëruese "krimb i pandershëm".

Me roman të ri vjen edhe shkrimtari Virion Graçi. Me një ironi sarkastike në romanin "Pëllumbat i vrasin natën" tregohet fati i ndryshëm i dy vëllezërve dhe i nënës së tyre që ka humbur kujtesën. Me neutraliteti gati gazetaresk ndaj fakteve, autori tregon si fijet tragjike të fatit njerëzor mund të mpleksen e të ndërvaren prej ngjarjesh kontinentale e ndarjesh botërore gjeo-politike si dhe nga shqyrtat e brendshme, instinktive e patologjike të njerëzve të rëndomtë tjetërsuar prej pushtetit pa caqe, dehumanizuar deri në barbari.

Mira Meksi vjen me librin "Hak marrja e Casanova-s" (novelë e tregime). Në të, një ekspeditë historiane të lashtësisë përdjekin misterin më të madh të jetës së Kazanovës, princit venecian të joshjes dhe njërit nga shkrimtarët më të mëdhenj

të Rilindjes europiane. Zbulimi i tij tregon jo vetëm biografinë e Kazanovës, por mbarë njerëzimin. Një tragjedi e padëgjues pason...

Agron Tufta prezantohet në panair me "Fabula Rasa" (e rishikuar), personazhi i Agron Tufës, përmes një dueli real dhe metaforik vihet në kërkim të vetvetes drejt shpallimit të shtresimeve të identitetit moral, psikologjik, drejt profilit shpirtëror. Dualizimi i njeriut, përpjekja e tij për ta mbytur realitetin duke kërkuar shpëtim në lexim, në libra, në një botë të cilën ai përpigjet ta ndërtojë brenda asaj që jeton, është përpjekje e stërmundimshme e njeriut për të shpëtuar nga hije, nga krimbi që rritet brenda shpirtit të tij e që e përcakton deri në skaj prejardhjen prej krimbaçëve të mëdhenj.

TOENA
"Letrat e mia kredenciale" është botimi më i ri i Besnik Mustafaj. Ai u promovua dhe në panairin e librit në një bisedë me Arta Markun.

Namik Dokle vjen me romanin "Ditët e lakuriqëve të natës", Subjekti i këtij romani shtillet rreth një fabule mbroslëfëse; sëmundja që po merr jetën e të rinjve nuk është "tërbin" i ardhur nga shkaqe që mund t'i shpjegojë shkencë. Ajo vjen nga ndalimi që u bëhet të rinjve të mos kenë asnjë mundësi të bëjnë dashuri.

Në fshat mbizotëron një shtetëritim i frikshëm mbi ndjesitë dhe nevojat shpirtërore dhe fiziologjike të të rinjve. Personazhet kanë veshur, të gjithë, petkat e tyre prej fjalësh të frikura dhe luajnë para syve tanë dramën e tyre, që është njëkohësisht drama e gjithë shoqërisë shqiptare në diktaturë. Heshja e frikshme mes banorëve për të artikuluar dyshimet, e pengon një profesor shkencëtar të njëjtë shtepi me të vërtetën. Laboratori i tij nuk është thjesht shkencor, por kryesisht njerëzor.

ALBAS

Dy romane nga shkrimtarët më të rëndësishëm bashkëkohorë i gjeuni në stendën ALBAS. "Uni i ndaluar" nga Peter Carey (2 herë fitues i Booker Prize) dhe "Zhurma e bardhë" nga Don DeLillo (një nga kandidatët më të diskutuar për çmimin Nobel), përkthyer nga Ukë Buçpapaj.

Seria për fëmijë "Më quajnë ..." (botime ALBAS) tashmë e mirënjohur dhe i aftë vlerësuar nga të rritur dhe fëmijë (me dy çmime Panairi), që flet

Besnik Mustafaj, Namik Dokle, Gazmend Kapllani, Zija Çela, Enkel Demi, Flutura Açka me vepra të reja



Ismail Kadare



në vetën e parë për figurat më të shquara botërore dhe shqiptare, tashmë pasurohet me Gegë Marubin, i fundit i të lavdishmëve MARUBI. Rita Petro thotë se i është mirënjohëse për bashkëpunimin autorëve të tekstit Albert Vataj, Zija Vukaj, si dhe Tonin Vasës për materialet informuese dhe përshkrimet plot ndjenjë për jetën dhe veprën e rrallë që këto personalitete të shquara na e lanë si trashëgimi nëpërmjet fonotekës Marubi. Në veçanti një falënderim i veçantë shkon për Entela Kasemi Beati dhe Sulid Kasemi Beati që me ilustrimet e tyre i kanë dhënë jetë kësaj serie të çmuar. (Së shpejti në përgatitje janë "Më quajnë Egrem Çabej"; "Më quajnë Onufri" "Më quajnë Ali Pashë Tepelena" (përgatitur nga Luan Rama); etj.

Po në Albanë janë tregimet e Francis Scott Key Fitzgerald, përmbledhje e titulluar "Një mal diamanti" përkthyer nga Ylli Pango.

E njëjta shtëpi botuese ka marrë të drejtën e botimit të veprës së një prej lirikëve më tipikë të letrave sh-

është vlerësuar më 2018 me Çmimin Shkencor Ndërkombëtar të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për studimet më të suksesshme për Gjergj Kastriotin - Skënderbeun në Vitin Mbarëkombëtar kushtuar figurës dhe epokës së tij. Vepra është ndarë në kapitujt: Arbërit dhe Arberia politike përpara pushtimit osman; Ekspandimi turk në kontekstin evropian-arbëror; Shfaqja dhe ngrija në histori e Gjergj Kastriotit; Shpallja e politikës së luftës; Drejt "Aleancës së krishterë"; "Luftefit i Krishtit" mes Turkut dhe Venedikut; Ballë-për-ballë me Muratin II; Mes papës Nikollë dhe mbretit Alfons; Mes Kalikstit III dhe Alfonsit V; Me Pium II në kulmin e politikës; Me kryqëzatën dhe pa kryqëzatën e Pium II; Në ballafaqim me "Mehmet Push-tuesin"; Zhgënjimi prej kurjes së Romës; Ballafaqimi i dytë me "Mehmet Push-tuesin"; Ethet e vdekjes dhe fundi; Skënderbeu - hero semantik; Fjalorët termash historikë; Shkurtesa të arkivave dhe bibliotekave; Bibliografi e autorëve të cituar ose të përmendur.

PEGI

"Dita e mbetur" e Kazuo Ishiguro, përkthyer nga Parid Teferiq hap siparin e nobelistëve në panair. "Dita e mbetur" është po aq e fortë, sa delikate, në studim i ndryshjes, me nuancë shumë të holla dhe shpesh gazmore. Në të analizohet "ndërgjegjja e urrejtjes" (jo tërësisht e palumtur) e një njeriu ... Është një libër vërtet origjinal dhe i shkruar kur Kur e lexon, ke përshkrimet e pazakotë se po kontrollohesh nga autori.

"Viljevo" i Luka Bekavac përkthyer nga Ben Andoni, është një roman që i kushtohet idesë se forca e shtypjes është në përjesëtim të drejtë me forcën e rezistencës e me dëshirën për liri, në Kroaci a kudo. Kjo histori përgjimesh e lufte për mbijetesë, si dhe përpjekjesh për ringritje, mund të jetë zhvilluar gjatë verës së vitit 1943, a kurdoherë.

"Udhëtimi i gjatë i Geri Hopit", nga Moony Witcher përkthyer nga Agim Doksani, romani fantazi për fëmijë tregon historinë e Geri Hop, një djalosh 13-vjeçar, i guximshëm dhe i zellshëm, që mbi të gjitha ka dëshirë të ndihmojë njerëzit që ka për zëmër. Takimi me Alinë, një vajzë të re nga fisi i Fiderbëve, do ta ndihmojë të ndryshojë këndvështrimin e tij për botën. Dy fëmijët, të destinuar për tu njohur për shkak të urrejtjes, shpejt do të jenë shoqë udhëtimi dhe, në fund,

do të bëhen miq për kokë. Romani "Pa frymë" i Lorenzo Amurri, përkthyer nga Beti Njuma, rrëfen historinë e vërtetë të autorit. Jeta e tij ishte e bukur; muzikë, miq, drogë dhe rock & roll. Lorenzo Amurri ishte njëri me fat, derisa, një ditë, teksa po bënte ski me të dashurën, Johanën, pëson një aksident të rëndë. Një çast më pas, është i shtrirë diku dhe po nxitojnë në spital. Oficiana, helikopterë, sulme ushtarakësh të ëndërruar e doktorë të vërtetë. Pas disa ditësh, ndërgjegjja kthehet sërisht dhe bashkë me të, tmerri i situatës së tij të re: është i paralizuar në pothuajse gjithë trupin e tij, nga gjoksi e poshtë. Ka vetëm një shpresë të vogël për qart, dhe duart për të janë të rëndësishme, pasi falë tyre ai është kitarist dhe muzikant, një ndër më të talentuarit të generatës së tij.

AUREL PLASARI
SKËNDERBEU
NJË HISTORI POLITIKE
Botim i dytë

IBK
Ribotohet Libri "Skënderbeu - Një histori politike" nga Aurel Plasari. Ai

CEREMONIA

Përmbushet amaneti, Mid'hat Frashëri prehet në atdhe

Eshtrat e Mid'hat Frashërit (i njohur edhe si Lumo Skëndo) prej ditës së djeshme prehen në atdhe. Amaneti i tij është përmbushur pas 7 dekadash nga dita ku ai u shua. Ka qenë nisimë e historianit Uran Butka dhe deputetit Agron Shehaj që amaneti të shkonte në vend. Për kthimin e eshtrave nga SHBA për në vendlindje të një prej firmëtarëve të pavarësisë dhe kryetarit të Kongresit të Manastirit, Këshilli i Ministrave akordoi fondin prej 3,239,400 lekë, për organizimin e procedurave të nevojshme ndërshtrëtorë. Mid'hat Frashëri ndërroi jetë në vitin 1949 në Nju Jork të SHBA-së. Nga Amerika eshtrat janë nisur pas një ceremonie që përfshinte edhe lutjet e imamit Gazmend Aga. Të mërkurën në mëngjes, arkëmorti me eshtrat e veprimtarit, politikanit dhe shkrintarit mbërritën në aeroportin e Rinasit rreth orës 09:00. Homazhet u mbajtën në hollin e Akademisë së Shkencave, ndërsa ceremonia u zhvillua te Kodrat e Liqenit Artificial, aty ku prehen vëllezërit Frashëri. Në ceremoni morën pjesë kryeministri Edi Rama, dhe të tjerë personalitete të vendit. Ka qenë protokollin i Kryeministrit që është kujdesur për gjithë udhëtimin e mbramë drejt atdheut. Megjithatë, ka pasur edhe incidente. Përfaqësues të Ballit Kombëtar nuk janë lejuar të marrin pjesë në ceremoninë e rivarrimit të eshtrave të Mid'hat Frashërit. Arsyetimi ka qenë mungesa e ftesave duke qenë se pjesëmarrja ishte me ftesa, dhe përfaqësuesit e Ballit nuk kanë mundur t'i sigurojnë ato për të gjithë. Për mediat, ata u shprehën se do të qëndronin derisa të largohen përfaqësuesit e lartë të qeverisë dhe më pas do t'i hidhnin një grusht dhe në varr.

HOMAZHET

Në homazhet e mbajtura në nder të tij, kanë marrë pjesë personalitete dhe politikanë të njohur të vendit. Ardashës, qytetarë, e historianë kanë përhëndetur këtë vendim. Ish-kryeministri i vendit Sali Berisha dhe kreu aktual i opozitës, Lulzim Basha kanë hyrë njëri-pas tjetrit në këtë ceremoni. Berisha u shpreh se Frashëri ka qenë promotor i luftës për liri, ndërsa Basha tha se qeveria bëri detyrën me vendimin për të sjellë në Shqipëri eshtrat e Mid'hat Frashërit në atdhe. "Ky burrë i madh i dha Shqipërisë, gjithçka kishte më të shtrenjtë. Kryesoi, bashkëkryesoi Kongresin e Alfabetit, vuri firmën në aktin themeltar të shtetit të shpalljes së pavarësisë, anëtar i qeverisë së parë të Ismail Qemalit, një studiues dhe kolos i letrave, themelues i nacionalizmit qytetar shqiptar, udhëheqës kryesor dhe drejtues i Ballit Kombëtar. Pas lufte, i përgjegjdhur nga anglo-amerikanët për kryeministër të Shqipërisë së lirë të ciluar nga diktatura, për përmbysjen e Hitlerit shqiptar Enver Hoxhës. Atij që në një akt hakmarrës do të urdhëronte eliminimin e tij fizik në dhomën e hotelit në Nju Jork duke përdorur falangat e tij terroristit", -tha Berisha. Ndërsa Lulzim Basha tek-

Pas debateve/ Rama: Të ulë kokën kush e sheh provokim. Basha: Shembull për shumë të tjerë



Ceremonia e rivarrimit të eshtrave të Mid'hat Frashërit

sa vlerësoi figurën poliedrike të Frashërit, që e quajti burrë të madh dhe shkencëtar të një dimensionit evropian shtoi se "është një nga ditët e rralla, që qëndrojmë para një arkëmorti me një sens krenarie, nderimi por edhe kënaqësi. Kënaqësi që u përmbush amaneti i tij, detyrim i madh kombëtar i gjithë patriotëve shqiptarë. Një shembull që duhet të ndiqet edhe për shumë të tjerë. Eshtrat e çdo patrioti që padrejtësisia e diktaturës gjakatare të Enver Hoxhës i kanë lënë të dërgjen jashtë vendit duhet të kthehen e të nderohen në Shqipëri" - tha Basha në një prononcim të shkurtër për mediat. Duke iu përgjig-

jur interesit të medias, nëse e vlerëson rolin e qeverisë shqiptare në këtë proces, Basha u shpreh se qeveria nuk bëri asgjë përveçse detyrën. "Vlerësoj iniciativën e historianit Uran Butka si edhe përkushtimin e deputetit Shehaj. Qeveria nuk ka asgjë më pak se detyrimin të kryejë procedurën për nderimin e këtij patrioti të madh" - përfundoi kreu i opozitës Basha. Ndërkaq, kryetari i Partisë Balli Kombëtar Demokrat Artur Roshi vërejti se sistemi diktatorial deformoi të vërtetën për Mid'hat Frashërin. "Ky veprim i qeverisë është një ndjesi nga të gjitha qeveritë. Një njeri nuk mund të jetë edhe bashkëpunëtor edhe ta

Incidenti, përfaqësues të Ballit Kombëtar nuk janë lejuar të marrin pjesë në ceremoni

luftojë kundërshtarin. Sistemi diktatorial deformoi jetën kulturore, historinë dhe deformoi edhe të vërtetën për kundërshtarin e sistemit, siç ishte Mid'hat Frashëri" - tha ai.

CEREMONIA


Në fjalën e hapjes së ceremonisë për varrosjen e eshtrave të Mid'hat Frashërit tek Liqeni Artificial, studiuesi Aurel Plasari e cilësoi Mid'hat Frashërin si një ndër gurat e shquara të kulturës shqiptare, me kontribute të çmuara në shumë lëmi. "Ai ishte një djalosh gjenial", theksoi Plasari duke cituar dy shkrime të thjeshta që datojnë në vitin 1887, të parat e botuara prej tij, ku njëri prej tyre i kushtohet Skënderbeut kurse tjetri dallimit mes koncepteve të dhe komb. "Pasioni i tij prej 17-vjeçari që përkthimi i letërsisë dhe përthekime të kryeveprave botërore "Vilhelm Telin" e Shilerit. Ky 17-vjeçar u ka dhuruar lexuesve të shqipes modelin e luftës për çlirim të një populli me dëshirë dhe dashuri të mëmëdheut, të jetesës dhe përparimit të atij populli prej punës së ndershme që e bën të lumtur dhe të pasur" - vijoi Plasari. "Mid'hat Frashërit quhet me bindje të plotë i patjetërsueshmi duke qëndruar mbi jetën dhe vdekjen, duke ruajtur balancën e shpirtit të në fatkeqësi ai mbeti i patjetërsueshëm në përmbushjen e misionit në tokë

me të cilin e kishte ngarkuar veten. Kryevepra që Mid'hat Frashëri i dhuroi kombit të tij është vet personaliteti i tij. Për të, krijimtaria dhe politika nuk qenë entitete të barabarta. "Të mbetesh i ndershëm ishte një model jetese që Frashëri ia këshillonte çdokujt tjetër, që për të ruajtur ndershmerinë dhe integritetin duhet të kesh aristokracizëm intelektual të cillin ai e ruajti deri në fund. Ky burrë pasurinë e vetme që pati, pra, librat ia la Shqipërisë", përfundoi studiuesi Aurel Plasari. Ndërsa kryeministri Edi Rama në fjalimin e mbajtur në ceremoninë e varrosjes së eshtrave, tha se Frashëri që "një mishërim dhe një shërbëtar i mëmëdheut sipas kokës së tij". Kryeministri u shpreh se ata që e baltosën për 7 dekada sot mbajnë buzët rrudhur. "Ai shfaqej si armik natyral sa herë tentohej përçarja. Të lë pa frymë pozicioni për dramën e popullsisë shqiptare të Camërisë të zhveshura për shkak të etnisë dhe besimit të tyre. Një amurmbajtës i shënuar i të drejtave të minoriteteve të lirive themelore, pa dallim etnie dhe feje. Shumë mund të kenë parë arrogancë, kokëfortësi, tërheqje, konservatorizëm apo besëthyerje virtutet e tij e bëjnë një personalitet pa të dytë në historinë e elitave të paqëndrueshme shqiptare", - theksoi kryeministri. Në rolin e shefit të ekzekutivit, ai tha se kthimi i eshtrave të Frashërit ishte një detyrim dhe borxh. "Mid'hat Frashëri i dha Shqipërisë gjithçka kishte e mundi. Gaboi, por në tërë sa bëri nuk nxiti kurrë me penën e tij një krim. Kush e sheh si provokim, bën mirë të ulë kokën e të kujtohet se sa krime bëjnë ata që shkruan historinë e gjensës tjetër të Lumo Skëndos. Kush e sheh këtë arkëmort dhe praninë time si kryeministër si revansh ndaj timarëve ndërsa përcjellim një gurrë shumëdimensionale, bën mirë të ulë kokën dhe të kujtohet se u rreshtuan edhe vetë kundër atij, të cilit i shkruante se nuk mund të kemi njerëz që kanë llyer duart me gjak duke bashkëpunuar me pushtuesit" - tha Rama. Ai kërkoi reflektim, kur tha se mjaft kemi gjykuar në mungesë. "Këtu janë eshtrat e një burri të dënuar në mungesë jo nga një gjykatë, por nga gjyqi i historisë së shkruar nga timarët për të poshtëruar të mundurit. Mjaft kemi shpifur, mjaft me shpërdorimim e atyre që nuk janë më. Kthimi i eshtrave nuk i merr askujt historinë, apo aftësinë e arsyetimit. Një varr nuk e mbulon një njeri të vdekur, nëse ideja rron e ngjall shpresa të të tjerët. Gjithë fatkeqësia jonë ka ardhur nga shpërndarja e këtyre fuqive" - u shpreh kryeministri.

Kush ishte Mid'hat Frashëri dhe pse debatohet për të

Biri i rilindësit të shquar Abdyl Frashëri, lindi më 25 mars 1880 në Janinë. Kishte edhe pseudonimet Lumo Skëndo dhe Mali Kokojka. E njohu shumë pak të atin e tij dhe u rrit në kujdestarinë e xhaxhallarëve, Sami dhe Naim Frashëri. Patriot, njeri i ditur, Mid'hat Frashëri deri në vitin 1905, punoi në administratën turke. U aktivizua në politikën shqiptare në fund të shekullit XIX dhe u bë një nga figurat më të spikatura në politikën shqiptare. Mid'hat Frashëri ka qenë pjesëtar i klubit të Selanikut në Manastir, ka botuar "Kalendarin Kombiar", ka themeluar gazetën "Liria", revistën "Dituria", dhe ka qenë kryetar i Kongresit të Manastirit dhe nënkryetar i Komisionit të Alfabetit. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 28 nëntor 1912 si delegat i Përmetit, Elbasanit dhe Pejës dhe nënkroi Aktin e Shpalljes së Pavarësisë.

Në qeverinë e Ismail Qemalit



u emërua Ministër i Punëve Botërore. Në kabinetet e Turhan Pashë Përmetit ishte ministër i Punëve Botore dhe Post-Telegrafës. Ishte anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, në vitet 1919 - 1920. Në vitet 1926 - 1939 hapi në Tiranë librarinë "Lumo Skendo". I përndjekur nga regjimi komunist me akuzën si themelues i organizatës së Ballit Kombëtar, Mid'hat Frashëri në përfundim të luftës u vendos në Itali e

më vonë në Londër, ku krijoi Komitetin "Shqipëria e Lirë". Mid'hat Frashëri nuk u martua. Varrimin e tij në SHBA e kanë organizuar përmes një ceremonie madhështore patriotët shqiptarë. Emri i tij ka hapur debat ndër vite, për shkak të rolit që ai ka pasur gjatë Luftës së Dytë Botërore. Së fundmi, historiani Marenglen Kasmi u shpreh se "shtrohet pyetja nëse mund të rivarroset në Shqipëri me nderë zyrtare një ish-bashkëpunëtor i nazizmit, pavarësisht meritave të tij të pamohueshme për shqiptarinë deri në vitin 1943? Këtu qëndron thelbi i diskutimit. A është antikomunizmi një vlerë përgjithëse që zeron bashkëpunimin me nazizmin?". Kasmi shtoi se gjatë asaj kohe Frashëri nënshkroi një memorandum që konsistonte kryesisht në krijimin pa lufte të një konfederate greko-shqiptare, me kufij të vitit 1939, si edhe që në rast lufte, komanda e përgjithshme ushtarake do të ishte në dorë të Greqisë.

Opinion i Ditës

Kongresi i Manastirit: aty ku njësimi i alfabetit u bë gur themeli për njësimin e gjuhës dhe të kombit

Nga Shezai Rrokaj

(vijon nga faqja 1)

...referohen studiuesit e historisë, të gjuhësisë, të letërsisë e folklorit, të didaktikës dhe kulturës janë pa dyshim, Kongresi i Manastirit (1908), i cili, me mënjanimin e alfabeleve të tjera shprehu në mënyrë të qartë idenë dhe vullnetin e shqiptarëve se uniteti i alfabetit, uniteti i gjuhës dhe uniteti i kulturës kanë qenë dhe janë kërkesa që përligjin dhe e bëjnë funksional unitetin politik të kombit.

S. Frashëri do të pohonte të "Gjuha shqip", se "Kombetë mbahenë me gjuhëtë, një komb që e humbet gjuhën e vet është i humbur dhe harruarë... (dhe se)... xhdo shqiptar, i madh e i vogël të mësojë këto shkronja e të munde të shkruanë" e të këndonë gjuhën e ti, që ka mësuarë me qumështit e s'ëmësë".

Është i njohur fakti se Rilindja Kombëtare ishte një lëvizje politiko-shoqërore, e cila u karakterizua nga një përpjekje e gjithanshme emancipuese me synime të qarta për shkëputje politike si dhe nxjerrjen nga prapambetja arsimore e kulturore nëpërmjet bashkimit dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare të shqiptarëve.

Ngjarja e dytë është Kongresi i Elbasanit (1909) dhe hapja e Shkollës Normale të Elbasanit (1909) për mësimin e gjuhës shqipe. Vendimet e tij kishin të bënin me mbrojtjen e gjuhës dhe vënien në zbatim të alfabetit të Manastirit.

Në zbatim të vendimeve të Kongresit të Manastirit dhe Kongresit të Elbasanit ishte hapja e Shkollës Normale për mësimin e gjuhës shqipe. Mësimi i gjuhës shqipe dhe masivizimi i shkollës ishin bërë kërkesë e ditës dhe vendimet kishin të bënin me mbrojtjen e gjuhës dhe zbatimin e alfabetit të Manastirit, me përgatitjen e mësuesve, hartimin e teksteve për mësimdhënien në gjuhën amtare në të gjitha lëndët dhe kategoritë e shkollave. Ky ishte një hap tjetër i rëndësishëm drejt njësimin të gjuhës shqipe.

Profesor Mehmet Çeliku e vlerëson Kongresin Kombëtar të Elbasanit si "një ngjarje e rëndësishme kulturore, arsimore e politike, ai është kongresi i shkollave shqipe dhe i gjuhës shqipe, është kurorëzimi i luftës së gjatë të Rilindjes Kombëtare shqiptare për identitetin kulturor shqiptar.

Ngjarja e tretë është Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës, e cila hedh për herë të parë themelet e një politike gjuhësore, në kuptimin teorik të këtij koncepti, po të mbajmë parasysh se për herë të parë kemi një mbështetje institucionale nga Komanda austro-hungareze me synime të qarta në këtë



drejtim. R. Elsie thekson se Komisia Letrare Shqipe u ngrit prej austro-hungarezëve "...me sugjerimin e konsullit të përgjithshëm August Ritter von Kral, për të vendosur në lidhje me çështjen e përdorimit zyrtar të drejtshkrimit, si dhe për të nxitur botimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe."

Komisia ishte një projekt madhor për një politikë gjuhësore, e cila do të krijonte një sinerji midis institucioneve qeverisëse të kohës dhe plejadës së intelektualëve, me qëllim kodifikimin e drejtshkrimit dhe unifikimin e variantit letrar që do të përfaqësonte gjuhën e administratës, të shkollës, të shtypit, të literaturës në tërësi dhe të kulturës së mbarë kombit.

Kjo politikë gjuhësore në dobi të formësimit të shtetit të ri shqiptar jepet në mënyrë të qartë nga S. Çeka, kur pohon se "Parimi dhe zbatimi i dialektit historik të Elbasanit dhe përgjithësimi i tij në qeveri me kulturë shkollore të trullit tonë asht një përparim i paçmuar dhe një... çap për bashkimin politik dhe letrar të dy copave të pashqitshme të Veriut dhe të Jugës."

Ngjarja e katërt e rëndësishme është Kongresi i Drejtshkrimit (1972) dhe gjithë hapat e mëtejshëm për të realizuar gjuhën e njësuar, si një vepër ku kombi do të realizojë për shtetin a shtetet e tij një konvergencë gjuhësore njësuere kryesisht në administratën publike, në shkollë dhe në media. Natyrisht, në harkun e këtyre ngjarjeve madhore dhe në përmblidhje të synimeve të tyre ka pasur përpjekje të tjera të rëndësishme dhe me arritje të pamohueshme, si: Shoqëria e Stambollit (1879), Shoqëria "Bashkimi" (1899) dhe Shoqëria "Agimi" (1901), Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920), Kongresi Arsimor i Tiranës (1922), Kuvendi i Parë i Studimeve Albanologjike (Tiranë, 1940), Instituti i Studimeve Shqiptare (Tiranë, 1940), In-

stituti i Gjuhësisë (Tiranë), Komisia Letrare Shqipe e Prishtinës (Prishtinë, 1968).

Ajo që i bashkon këto ngjarje është fakti se çështja gjuhësore nuk ka qenë qëllim në vetvete dhe për vetvete; ajo shërbente si mjet për një qëllim më të madh: njësimi i alfabetit ishte një fillim për njësimin e gjuhës si mjet, për të mbërritur mandej të njësimi i kombit nëpërmjet shkollës, letërsisë e kulturës, me qëllim që të vihej më mirë në qarkullim dija kombëtare shtetformuese, si pronë e bashkësisë, për të realizuar unifikimin vetëdijes si komb; një vetëdije e brendshme në gjithë rrugëtimin prej Rilindësve tanë e këtej.

Ndaj mund të pohohet pa mëdyshe se qysh prej Kongresit të Manastirit çështja e njësimin të alfabetit dhe gjuhës nuk ka qenë qëllim në vetvete. Me ndonjë përjashtim, kjo çështje ishte e lidhur ngushtë me kërkesën e njësimin kombëtar dhe të autonomisë, sepse programi i lëvizjes kombëtare është i lidhur me procesin e formimit të ndërgjegjes kombëtare dhe të unitetit kombëtar. I përmbahem mendimit se kjo sinerji e unitetit të alfabetit, të gjuhës dhe kulturës në shërbim të unitetit të kombit është një politikë gjuhësore, herë në trajtën e përpjekjeve sporadike të qarqeve të caktuara qysh prej rilindësve e herë si një angazhim shtetëror prej Komissisë e në vazhdim. Pavarësisht nga veçanësitë dhe kushtet historike që kanë ndikuar në qëndrimet përkatëse ajo që i bashkon këto ngjarje historike është larmia e pjesëmarrësve dhe formimeve të tyre si: studiuues e krijues në gjini të ndryshme, apo edhe patriotë, shtetarë, fetarë etj.

Prej Kongresit të Manastirit e këtej nis një rrugëtim pa kthim drejt:

Së pari, eliminimit nga diskutimi i alfabeleve arabo-turke e greke dhe zgjedhja e alfabeleve me bazë latinishten. Kjo zgjedhje ishte

padysim më pak një vazhdim tradite të autorëve të vjetër sesa një shprehje vullneti për të qëndruar larg alfabeleve me të cilët lidheshin vendet që synonin të na asimilonin a të na copëzonin. Një alfabet larg fqinjësisë territoriale e larg alfabetit të pushtesit ishte një garanci më shumë për një autonomi dhe një pavarësi kombëtare.

Së dyti, zgjedhja e dy alfabeleve në Kongres tregonte se do të duhej ende kohë që klubet të hiqnin dorë nga ndasitë, copëzimet dhe kaosi grafik për t'u përfshirë gradualisht në një lëvizje unitare kombëtare në kuptimin e gjerë. Siç do të shihet më tej, edhe pse me dy alfabe, Kongresi jo vetëm i dha fund larmisë grafike të deriatëhershme, por edhe shërbeu, në vijim të Lidhjes së Prizrenit, si një fillesë për një funksionim të kombit në tërësinë e elementeve që e përbëjnë atë.

Së treti, është pak e besueshme që zgjedhja e dy alfabeleve të jetë bërë për të shprehur a respektuar bashkësinë veri/jug e ca më pak atë fetare në myslimanë e të krishterë. Faktori i jashtëm, i cili është përdorur si argument diskutimi nga studiuesit për të dhënë interpretime të ndryshme, lidhet me shumë me përdorimin praktik të shtypshkronjave, që asokohe mbështeteshin në karakteret latinë.

Së katërti, njësimi i alfabetit ishte një fillim për njësimin e gjuhës si mjet për të mbërritur të njësimi i kombit nëpërmjet shkollës, letërsisë e kulturës, që do të vinin më mirë në qarkullim dijen kombëtare si pronë e bashkësisë për rritjen e vetëdijes njësuere.

Kongresi i Manastirit u dha shqiptarëve përfundimisht një alfabet latin, i cili ua ktheu përfundimisht syrin nga Perëndimi, i largoi ata prej kthetrave të turqve dhe lakmive territoriale të fqinjëve. Nga vetë natyra e saj, gjuha shërbeu si mjet për formësimin kombëtar. Një alfabet, një gjuhë pa

thyerje të mëdha dialektore, një shoqëri shqiptare e emancipuar, që duhej të zgjohej dhe të bashkohej nëpërmjet shkollimit dhe kulturimit, mbeten sot e gjithë ditën, prej Rilindësve në kohët e moderne, rruga si duhet të bëheshin dhe do të formësoheshin Shqipëria dhe shqiptarët.

Edhe në kohët e sotme debatet nuk kanë vënë në diskutim vetëdijen arketipike të njësimin gjuhë-komb. Ato kanë qenë kryesisht të lidhura me bazën dialektore të gjuhës së njësuar, pas pohimeve në Kongresin e Drejtshkrimit (KD) për të ashtuquajturën bazë mbidialektore të gjuhës letrare, për kriteret e zbatuara për normën drejtshkrimore, për lidhjen e gjuhës së njësuar me sistemin komunist, për pasurimin, rishikimin, zëvendësimin e saj a krijimin e një standardi tjetër etj. Këto debate kanë mbetur të mbërthyer hera-herës në një mendësi akuzuese, pa mundur të jepen zgjidhje racionale normative për gjuhën shqipe, e cila, si një dukuri dinamike, ndryshon e larmohet, duke iu përshatur rrethanave shoqërore të reja e ku, si në çdo gjuhë tjetër merr trajtën e një gjuhë në përdorim.

Sot është koha që problemet e gjuhës së njësuar të kundroheshin nga këndvështrimi i gjuhës në përdorim, i cili është përcaktues për normën e çdo gjuhë. Si shumë studiues të tjerë, mendoj se një debat dobiprurës për çështje të caktuara për gjuhën e njësuar, larg shigjetimeve, i mbështetur kryesisht në studiet dhe në institucione, mund të na shpërjë drejt dhënies së disa zgjidhjeve në fushë të drejtshkrimit, pas të cilave lipset një politikë planifikuese gjuhësore mbarëkombëtare.

Nga ana tjetër, i përmbahem, gjithashtu, mendimit se me gjithë diskutimet e debatet gjuha e njësuar, edhe pse ende në proces formësimi, e mbrojt gjuhën shqipe prej "krisjes gjuhësore", ipso facto edhe "krisjes kombëtare", që po realizohet gradualisht për shkak të copëtimit gjeopolitik të kombit në disa shtete, e ku shqipja, sikundër vetë shqiptarët po formonin një arkipelag gjuhësor pa mundësi komunikimi brenda etnike prej një "ishulli" gjuhësor tek tjetri. Njësimi i gjuhës nëpërmjet një gjedhje njësuere për shqipfolësit ishte antidoti më i efektshëm e kulturës, që do të vinin më mirë në qarkullim dijen kombëtare si pronë e bashkësisë për rritjen e vetëdijes njësuere.

Kongresi i Manastirit u dha shqiptarëve përfundimisht një alfabet latin, i cili ua ktheu përfundimisht syrin nga Perëndimi, i largoi ata prej kthetrave të turqve dhe lakmive territoriale të fqinjëve. Nga vetë natyra e saj, gjuha shërbeu si mjet për formësimin kombëtar. Një alfabet, një gjuhë pa



Letër Kryeministrit

Një propozim për të ndihmuar artin në Shqipëri

Nga Limos Dizdari

(vijon nga faqja 1)

... e Artit "Dea" në Ksamil, të funksionojë me atë dimension dhe vlera që patëm parë në atë ëndërr të madhe që na kushtoi për 18 vite të jetuara nga jeta jonë shoqërisht shumë e dobishme dhe pa asnjë interes, e që me siguri, i merrni me mend vështirësitë e shumta që kemi kaluar.

Ideja jonë për të bërë një Teatër Operë në Ksamil, brenda një qendre kulturore reale e të vërtetë, si kjo këtu, në dukje të parë të lehtë përshypjen e një "marrëzije" ekstreme.

Në realitet, nisiativa jonë, e Limosit dhe e Adrianës, është një guxim i veçantë e shumë i dobishëm, që i pararend shoqërisë e progresit të tij, jo vetëm si nevojë për plotësimin e ca vlerave specifike shumë të ndryshme të jetës artistike, që padyshim rrisin cilësinë e të jetuarit, dhe më e rëndësishmja, bëjnë të mundur kohë-zgjatjen e turizmit në këtë cep të largët të bregdetit shqiptar.

Vullneti për të realizuar një Qendër Artistike multifunksionale, brenda së cilës ka edhe një Teatër Operë apo të Dramës, na prezanton si një komb dhe shtet me interesa të larta intelektuale dhe na afron më shumë pranë familjes së madhe Europiane, ku duam të aderojmë.

Është një rrugë nëpër të cilën kanë kaluar të gjitha shtetet e këtij kontinenti, sa të lashtë aq dhe të mençur, që na bëjnë më ëndërrimtar në rrugën tonë drejt tyre.

Me shprehjen e një ambicije që na i detyron pasionit dhe ëndrra për



të bërë atë që duhet, duke shtyrë dhe hedhur poshtë si një leckë të pa vlerë, ndrojtjen dhe turpin, kini mirësinë, të planifikoni në buxhetin e ri të shtetit për viti 2019 për Teatrin "Dafinat" në Ksamil, një shumë prej 10 milionë lekësh e barabartë kjo me afërsisht 6-7 për qind të buxhetit të Teatrit të Operës (T.O.B.), për të realizuar vepra skenike operistike, teatrore, koncerte vokale, konkurse kombëtare apo ndërkombëtare, mbremje baleti, koncerte të fjalës

artistike, koncerte të muzikës së dhomës, të romancës, këngës së zgjedhur e atë qytetare. Gjithashtu, do bëjmë çdo përpjekje për të sensibilizuar opinionin e donatorëve të tjerë, për të bërë të mundur ta ndërtojmë këtë veper madhore e po ju drejtohem si ligjëvënës dhe si njerëz me përgjegjësi të lartë e të shenjtë, të hartoni buxhetin e ri të shtetit që, Ju kërkojmë që së bashku të përpiqemi që kjo Qendër, e ky Teatër, të funksionojë si një institucion artistik i vyer, alternativ e krahasues.

Dëshirojmë ta konkretizojmë këtë ide, të cilën mund ta ndërprisni në çdo kohë, nëse konstatooni një shkelje, një mungesë sado të vogël apo të pa rëndësishme.

Nëse ndodh se ky projekt ka shpërdoruar besimin Tuaj, apo atë të parlamentit e të provuar nga Ministria e Financave, pranojmë çdo lloj penaliteti ekonomik e administrativ.

sitet më të lartë gjatë sezonit turistik.

Arsyeja e këtij efektiviteti të lartë, është e thjeshtë : ...leku i këtij fondi nuk mund të vidhet, ai nuk mund të shpërdorohet, nuk mund të zhvlefteohet dhe nuk ka asnjë mundësi që ky fond të mos kryejë detyrat e atyre qëllimeve për të cilat është akorduar. Ky fond është i detyruar vetëm të kontrollohet si shpenzim financiar i destinuar të prodhojë vetëm vlera artistike të realizuara si dobi shoqërore kombëtare e pse jo edhe ndërkombëtare.

Ju bëjmë me dije znj. Albana, si unë ashtu dhe Adriana, dëshirojmë me çdo kusht të përmushim misionin tonë që kemi dhe asgjë tjetër më shumë.

Me një kosto ekonomike të rendë, (rreth 900.000 \$), me një kohë fizike të konsumuar, prej 18 vitesh si dhe përmes një përkushtimi të dy njerëzve të arratisur e të terratisur në një nga cepat me jugor të vendit, bëjmë të mundur ta ndërtojmë këtë veper madhore e po ju drejtohem si ligjëvënës dhe si njerëz me përgjegjësi të lartë e të shenjtë, të hartoni buxhetin e ri të shtetit që, Ju kërkojmë që së bashku të përpiqemi që kjo Qendër, e ky Teatër, të funksionojë si një institucion artistik i vyer, alternativ e krahasues.

Dëshirojmë ta konkretizojmë këtë ide, të cilën mund ta ndërprisni në çdo kohë, nëse konstatooni një shkelje, një mungesë sado të vogël apo të pa rëndësishme.

Nëse ndodh se ky projekt ka shpërdoruar besimin Tuaj, apo atë të parlamentit e të provuar nga Ministria e Financave, pranojmë çdo lloj penaliteti ekonomik e administrativ.

pëlqyeshëm në disa veprimtari shoqërore si: në letërsi, në shkencë, në shkollë, në administratë e në lëmenjtë e tjerë të kulturës kombëtare në trojet etnike ku jetojnë shqiptarët. Ajo u përdor në trevat etnike të shqiptarëve si mjete më i rëndësishëm integruar kombëtar i shqiptarëve të shpërndarë në disa njësi administrative shtetërore. Ndërkaq jeta e shqiptarëve kudo ku jetojnë, nga ajo kohë gjer sot, ka ndryshuar shumë dhe krahas këtyre ndryshimeve janë rritur dukshëm edhe prurjet e reja letrare e shkencore dhe jeta e përgjithshme kulturore e tyre.

Parimi i kompromisit të natyrisht brenda bashkëveprimit ndër-dialektor midis ish-varianteve të shqipes letrare dhe jo vetëm, prej Rilindjes Kombëtare e këtej, ka ndikuar pozitivisht në njësimin e gjuhës shqipe, duke qenë i efektshëm për zhvillimin e përgjithshëm të standardizimit të saj.

Aspiratat e përgjithshme të sh-

qiptarëve orientohen drejt integritimit të Bashkimit Evropian dhe paralelisht drejt bashkimit kombëtar. Kjo gjë kërkon në radhë të parë që shqiptarët medoemos duhet të kenë një gjuhë të njësuar të vetme, por dhe funksionale e të zbatueshme në të gjitha viset etnike ku ata jetojnë. Sot gjuha e njësuar është mjete kryesor për mbrojtjen e identitetit të njësuar kombëtar edhe përballë trysnisë së gjuhëve dhe kulturave të huaja në periudhën e shoqërisë globale që po jetojmë.

Prirja e përgjithshme (por jo vetëm) për ndërhyrje drejtshkrimore në standardin tonë vjen prej disa faktorësh ndër të cilët veçojmë: dinamizmin e zhvillimit të vetë standardit që lidhet edhe me ndryshimet e sistemit dhe ndryshimet gjeopolitike, kryesisht në dy dekadat e fundit. Por edhe vetë Kongresi i Drejtshkrimit (1972), i cili me gjithë punën e konsiderueshme, të bërë nga studiuesit dhe institucionet, nuk mund të mbyllte gjithçka plotë-

sisht dhe drejt për arsye të mosnjohjes plotësisht të të gjithë arëalit gjuhësor të trevave shqipfolëse, që vinte nga gjendja e pamjaftueshme e studimeve dialektologjike të kohës, të cilat nuk ishin gjithmonë konverguese, për shkak të copëtimit politik të kombit tonë. Nga ana tjetër, me gjithë punën e palodhur të studiuesve tanë, përgatitja teorike vuante defektet e izolimit dhe të mungesës së një shkolle teorike gjuhësore ad hoc. Gjithashtu, Kongresi i Drejtshkrimit i la shumë çështje të hapura për t'u ndjekur në dinamiken e mëtejme të zhvillimit të gjuhës. Por, nëse në kohën e KD disa vendime u morën edhe në emër të një idealizmi kombëtar pragmatik, për shkak të copëtimit gjeopolitik të kombit, sot shqiptarët lëvizin lirisht në arteritë e kombit dhe bashkë me ta edhe gjuha e tyre. Kombi dhe gjuha e tij e njësuar nuk është më një ëndërr, një aspiratë, por një realitet i prekshtëm, i përditshëm, i provuar dhe në

proces formësimi, ndaj dhe zgjidhjet duhet të marrin parasysh këtë realitet të ri.

Prirja globale integruese ndërkombëtare ka sjellë vetiu edhe prirjen integruese kombëtare. Në këto kushte shqiptarët nuk mund të kenë dy standarde gjuhësore e as nuk mund të nisin nga e para një të ri. Zgjidhja e vetme është zgjerimi dhe përmirësimi i këtij standardi drejt gjithëgjuhës. Kjo do të thotë se standardi duhet të pranojë natyrshëm për nevojat e veta prurje nga gjithëgjuha, kryesisht nga trevat jashtë kufirit politik të Shqipërisë. Nga ana tjetër, është e domosdoshme sot që të ndërtohen politika gjuhësore që mundësojnë shtrirjen e gjuhës së njësuar në tërësinë e shqiptarëve brenda kombit, me qëllim që shqiptarët të arrijnë një kohezion më të shpejtë shpirtëror e gjuhësor dhe një komunikim me frekuencë më të lartë në të gjitha fushat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, arsimore, edukative etj.

HOROSKOPI

DASHI

Yjet ju sugjerojnë që të bëni më shumë kujdes me punën. Nga ana profesionale shumë të lindur në këtë shenjë do të kenë suksese të mëdha. Sa i përket shëndetit, ai parashikohet të jetë i mirë.

DEMI

Në karrierë mund të keni një promovim që vjen si rezultat i punës tuaj. Ata që kanë biznese, mund të shohin frytet e para. Në jetën familjare dhe atë të dashurisë, megjithatë nuk do të shpëtoni pa zhgënjime.

BJNJAKET

Ajo që do të bjerë në sy për të lindurit në këtë shenjë është pikërisht karriera, por edhe dashuria. Sot në punë do të gjendeni para disa situatave të vështira. Gjërat do të përmirësohen në pjesën e dytë të ditës.

GAFORJA

Do të ketë risi në vendin e punës, ndërkaq nuk do ju mungojë as energjia dhe entuziazmi për karrierë. Mund të përballeni me disa vështirësi financiare, por gjërat do rregullohen falë aftësive tuaja.

LUANI

Parashikohet që disa prej të lindurve në shenjin tuaj të marrin disa lajme të mira. Është momenti që të mendoni për të investuar në një projekt afatgjatë. Në dashuri mund të keni disa probleme komunikimi.

VIRGJERESHA

Sukseset më të mëdha do të paraqiten në karrierë. Në dashuri do të keni disa lajme të mira dhe të këqija. Ndërkaq shëndeti do të jetë shumë i mirë në pjesën e dytë të ditës fale energjisë pozitive që rrethon.

PESHORJA

Parashikohet fat sa i përket financave. Sa i përket gjendjes së përgjithshme do të jeni shumë të relaksuar. Së shpejti parashikohet një ndryshim madhor që mund të prekë vendin e punës. Ndryshimi mund të jetë për mirë.

AKREPI

Sot do të mund të shijoni sukseset tuaja në punë dhe në karrierë. Megjithatë, duhet të jeni më të bindur në arritjen e qëllimeve tuaja. Nëse merreni me biznes, identifikojeni punën dhe angazhimin tuaj.

SHIGJETARI

Kini durim që të mund të punoni me qetësi. Një projekt mund të mos ju ecë mirë. Duke nxitur optimizmin është mënyra më e mirë për të përballuar me qetësinë e nevojshme vështirësitë që mund të lindin në stafin e punës.

BRICJAPI

Disa probleme të zakonshme në punë do ju shqetësojnë gjatë gjithë ditës. Jeta profesionale do të komplikohet nga mungesa e dukshme e suksesit. Fatmirësisht do të keni pranë ndihmën e partnerit.

UJORI

Karriera juaj sot do të ketë rritje. Promovimet në detyrë nuk do të mungojnë dhe për pasojë edhe të ardhurat nuk do të mungojnë. Në dashuri duhet më shumë përkujdesje nga ana juaj.

PESHQIT

Në pjesën e parë të ditës do të keni përparime në punë. Do të karakterizoheni nga vetëbesimi, një gjë që do ju ndihmojë. Bëni më shumë kujdes me shëndetin dhe tregohuni më i vëmendshëm ndaj ushqimit.

SEANCA E DJESHME

Përfaqësuesja e Shqipërisë kreu pasditen e djeshme edhe seancën e tretë stërvitore në kuadër të sfidës me Skocinë këtë të shtunë. Si zakonisht, trajneri Panuçi e nisi me një bisedë të shkurtër me lojtarët. Eros Grezda ka vijuar të stërviteti



Grezda alarmon Panuçin, Ndoj stërvitet veçmas

diferencuar për shkak të një lëndimi në pulpën e djathtë, edhe pse do të provojë të bëjë gjithçka të jetë gati për ndeshjen e pas ditëve. Veçmas grupit, ka zhvilluar stërvitje edhe mesfushori i Breshias, Emanuele Ndoj. Migjen

Basha, që paraditen e sotme kreu një seancë rikuperuese, prej faktit se vetëm të hënën luajti me Arisin e Selanikut, në seancën e pasdites mori një ngarkesë të plotë. Sidoqoftë, Basha nuk do të jetë i gatshëm për Skocinë, për kartonë,

ndërkohë që do të rikthehet ndaj Uellsit më 20 nëntor. Ekipit i është bashkuar, gjithashtu, edhe Elhan Kastrati, ish-portieri i Teutës që tashmë është pjesë e Peskarës në Itali, duke zëvendësuar kështu Alban Hoxhën, i cili vazhdon të shfaqë probleme në ligamentin e gjurit të djathtë.

MERKATO



Juventus mendon për Zhordi Albën

Juventus vazhdon të jinspektojë tregun për lojtarë që mund të afrojnë në janar dhe siç raporton "Tuttosport", nuk po heq dorë nga Zorani Alba, kontrata e së cilit përfundon në vitin 2020. Bardhezinjtë janë të fokusuar në përforcimin e prapavijës, pasi Aleks Sandro me shumë gjasa do të largohet. Braziliiani është një objektivi i Manchester Junajtid dhe PSG-së dhe me shumë gjasa do të largohet. Alba vlerësohet 35 milionë euro nga Barcelona dhe Juventusit pritet të përfitojë një shumë të përafërt për shitjen e Sandros. Me shumë gjasa, 29-vjeçari spanjoll do të transferohet në Torino në muajin janar.

Interi dëshiron Herrerën e Portos

Interi është në bisedime të avancuara me Porton për mesfushorin Hektor Herrera, i cili duket i vendosur të refuzojë Arsenalin për zikaltërit. Lojtarit meksikan i skadon kontrata me Porton në fund të sezonit dhe klubi portugez është gati ta shesë në janar që të përfitojë diçka nga largimi i tij. 28-vjeçari do të nënshkruajë një para-kontratë me Interin, por dot i bashkohet zikaltërve në fund të sezonit, pasi drejtuesit italian nuk preferojnë të paguajnë për të. Porto nuk është dakord me këtë vendim të Interit dhe i ka bërë "presion" zikaltërve se do ta shesë lojtarin të një skuadër tjetër, çka ka bërë që Interi të mendojë seriozisht që të paguajë që në janar për shërbimet e Herrerës.

Gjykata e Lozanës i kthen përgjigje televizionit "News24": Nuk ka asnjë apelim në program


Dyshimi për mungesën e apelimit, KAS përballë Skënderbeut

Korçarët reagojnë: Është e pavërtetë, kemi apeluar



Jeton Selimi

Në një kohë kur të gjithë janë sy e veshë nga Lozana dhe në pritje të gjyqit përfundimtar mes Skënderbeut dhe UEFA-s në lidhje me pezullimin 10-vjeçar nga Kupat e Europës, duket se gjërat diku kanë ngecur duke vënë në dyshim atë çka klubi kampion i Shqipërisë ka thënë deri më tani. Të paktën kjo është ajo që del nga e-mail që redaksia e 'SportNeës' ka shkëmbyer me sekretariatit e Tribunalit të Arbitrazhit Sportiv në Lozanë, shkalla e fundit e gjyqimit të betejës disa vjeçare mes kampioneve të Shqipërisë dhe raportit të inspektorëve të UEFA-s, që përpiqun masën ekstreme për bardhekuqtë. Sikundër është shkruar dhe folur shpesh nëpër media, gjyqi përfundimtar pritej të bëhej në tetor, më pas u shty në dhjetor dhe së fundmi nga ana e drejtuesve bardhekuq u dha muaji janar si periudha kohore kur do të vihen pikat mbi "i". Por në një vëzhgim të shpejtë të seancave të programuara, rezultat se deri më 15 janar nuk ka asnjë çështje "Skënderbeu" në program. Kështu, kërkesës sonë drejtuarit sekretariatit të Gjykatës së Lozanës për të mësur nëse ka një apelim dhe nëse mund të mësonim datën e një gjyqi të mundshëm, KAS iu përgjigje se Skënderbeu nuk ka apeluar fare: "Faleminderit për



mesazhin tuaj dhe interesin për aktivitetet e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv. Duke parë të dhënat tona, nuk na shfaqet të kemi marrë ndonjë apelim sa i përket çështjes që ju përshkruani më poshtë". Kjo përgjigje e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv shton dhe me shumë dyshimet mbi këtë

çështje, në një kohë kur presidenti i Skënderbeut Ardian Takaj i kontaktuar nga "News24" theksoi se klubi që ai përfaqëson e ka apeluar vendim e UEFA-s madje është përcaktuar dhe trupa gjyquese, por sigurisht nuk ka ende një datë. Gjithsesi një gjë është e sigurt, mes dy palëve njëri ka të

drejtë. Deri tani, përgjigja zyrtare e KAS i jep të drejtë këtij të fundit.

REAGIMI I SKËNDERBEUT

Pasditen e djeshme ka pasur zëra se Skënderbeu mund të mos e ketë apeluar në KAS-in e Lozanës çështjen e dënimit 10-vjeçar për të mos marrë pjesë në Kupat e

Europës. Gjithçka ka nisur nga një komunikim elektronik që "News 24" ka pasur me sekretariatit e KAS-it, ku përgjigja e këtij të fundit ka qenë se nuk rezultonte të kishte një apelim të Skënderbeut. Klubi korçar ka reaguar zyrtarisht në lidhje me këtë çështje, duke publikuar letërkëmbimin e fundit me KAS-in me foto, ndërkohë që shpreh indinjatën për lajmet e fundit, duke akuzuar qarqe të caktuara për "luftë" kundër Skënderbeut. "Duke marrë shkas nga lajmi i shpërndarë në mediat online, KF Skënderbeu siguron opinionin publik dhe sportdashësit bardhekuq se klubi ka apeluar vendimin e UEFA-s në CAS dhe jemi duke pritur datën e seancës dëgjimore. Dokumenti i publikuar më poshtë i përket datës 29 tetor dhe është letër këmbimi i fundit mes palëve në proces, dokument i cili hedh poshtë pretendimin e mediave vizive dhe online se në CAS nuk ka një apelim nga KF Skënderbeu", lexohet ndër të tjera në komunikimin e klubit kampion të Shqipërisë.

PRESIDENTI I SKËNDERBEUT

Takaj: Kemi apeluar brenda afateve, presim vetëm ditën e gjyqit

Presidenti i Skënderbeut, Ardian Takaj, ka reaguar menjëherë pas lajmit se klubi korçar nuk ka apeluar çështjen e dënimit në KAS-in e Lozanës. Në një bisedë për "Panorama Sport", ai sqaroi: "Është qesharake të dëgjosh se pas atij dënimi me vdekje që na dha UEFA, ne nuk kemi apeluar në KAS. Nuk është aspak e vërtetë ajo çfarë thuhet. Ne e kemi apeluar çështjen duke respektuar afatet ligjore. Madje mund t'ju them se korrespondencën e fundit me KAS e kemi pasur jo më larg se një javë më parë. Tashmë po presim ditën e gjyqit, që është në dorë të KAS, tek sa ky organ nuk pyet askënd se kur do të bëj procesin. Thjesht jemi në pritje".

Aktiviteti kriminal shkon deri në 4.5 miliardë euro

Itali, mafia kontrollon bastet 'online', 68 arrestime, aksione edhe në Shqipëri


Në një kohë kur në Shqipëri, mbyllja e basteve ka marrë dhe dekreton e presidentit një mega-operacion është zhvilluar në Itali. Sipas mediave italiane gjatë orëve të fundit janë kryer 68 arrestime. Nga hetimet e autoriteteve italiane, anti-mafia dhe anti-terrorizmi janë konfiskuar mallra në Itali dhe jash të këtij vendi me vlerë 1

miliard euro. Aktiviteti kriminal i mafias në bastet sportive, sipas hetuesve shkon në 4.5 miliardë euro. Ata që përfitonin më shumë nga bastet online ishin anëtarë të rëndësishëm të kimit të organizuar në Pulja, Rexhina dhe Katania, si dhe disa sipër-

marrës dhe zyrtarë. Po ashtu ka rezultuar se paratë e fituara transferoheshin jashtë Italisë. Një nga vendet ku janë investuar këto para është dhe Shqipëria. "Për të gjurmuar pasuritë e akumuluar dhe për të bërë konfiskimet ishte e domosdoshme bashkëpun-

imi i Eurojust dhe autoritetet gjyqësore në Austri, Zvicër, Mbretërinë e Bashkuar, Serbia, Shqipëria, Spanjë, Maltë etj", shkruajnë mediat italiane. Ai që zbuloi gjithë skemën ishte një i penduar që tregoi gjithë mekanizmin.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë e pasur me minerale.
7. Ascolli në tabela.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Premtojnë të bëhen kampionë të tillë.
14. Janë felinë të egër.
16. Marubi i fotografisë.
18. Janë meduza.
19. Një anarkist i famshëm.
21. Smith filozof.
22. Susanna shkrimtare italiane.
23. Shkurt për company.
24. Organizma Autonome Kombëtare.
27. Mbarojnë punime.
28. Ndezur në aparatë.
29. Bëjnë ekt me re.
30. Nduket për gjysmë.
31. Mbyllin fushatat.
32. Luca bomber.
34. Emri i parë i Pasolini-t.
35. Një mund të jetë fetar.

37. Lidhen të parat.
38. Fundi i një faze.
39. Emri i Bismarck.
40. Kant e Diabolik.
42. Ze... në traget.
44. Entë Informacioni Rajonale.
45. Triolet e Trëndafili me kredi.
47. Rruga e Ferenc Molnar.
48. Në krye të notarëve.
50. Gjysmë tatimi.
51. Ushtrihet me cd false.

VERTIKAL

1. Numër i shkurtër.
2. Britame Arkimedit.
3. Inicialet e Paganini-t.
4. Fundi i Turandot.
5. Eshhtë fjetore ushtarësh.
6. Parker regjisor.
7. Kështu quhet që ushqim kundër intoksikimit.
8. Një birrë e jona.
9. Mund të jenë përirimi.
10. Festat pa fat.
11. Qendër ditore.
13. Janë nomadë.
15. Fillojnë atletikën.
16. Eshhtë brinjë në skuadër.
17. Sidney i Serpico.
18. Qe centauri që mësonte Akilin.
20. Në mes të një kanali.
25. Bëhet për zakon.
26. Tregon martesë.
27. Një super... për shopping.
33. Vala e stadiumit.
34. Fillojnë poshtë.
36. Një provë... inteligjence.
38. Vaçë e famshme e këngës tonë.
41. Fillojnë vallen.
42. Para es Salaam.
43. Linearë pa larë.
46. Nota e diapozitit.
47. Mbyllin një shtëpi.
49. I keni në dorë.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Eshhtë skuadra e donatorëve.
7. Mbyllin një turp.
9. Mund të jetë unik.
11. Një i absurdit është i Samuel Beckett.
14. Qyteti i përjetshëm.
15. Interpreton Sandokan.
17. I ka tek tenda.
18. Eshhtë këngëtar lirik.
19. Arturo i Brecht.
20. John, i forti i Sylvester Stallone-s.
21. Françesku kantautor.
22. Eshhtë religjion politeist.
25. Qerre pa qe.
26. Gjysmë alarmi.
27. Eshhtë shtypi i ZP.

VERTIKAL


30. Kush ka... ka zët.
31. Altini mesfushor.
32. Janë vajzat në atletikë.
34. Eshhtë shpend lagune.
36. Gjysmë thyese.
37. Udhëhoqi Argonautët.
39. Mund të jenë fotografikë të tillë.
40. Fillojnë panikun.
1. Janë çnjerëzore.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Edi në krye të PS.
4. Eshhtë lloj papagalli.
5. Fund turni.
6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
7. Para devils për lojtarët e Manchester United.
8. U shkrua nga Kadare.
10. Conan ai i Schwarzenegger.
11. Pak titanike.
12. Arbeni pa çifte.
13. I ka tek treni.
15. Mund të jenë pushimi.
16. Mund të prishej nga je... kleçkë.
18. Në krye të bashkisë.
20. Eshhtë kundërshtar në dashuri.
23. Meta në krye të LSI.
24. I vidhet ustait.
27. Jeppet e Artë në Cannes.
28. Eshhtë pije e jona.
29. Kufizojnë kënde.
31. Fillojnë lehtë.
33. Eshhtë dritëshkurtri.
35. Eshhtë numri i... të parit.
38. Fillojnë nazet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

6	3			1	9		
9		4		5	6	1	3
				9			8
1				8		7	9
	6					2	1
2		5	1				
	5				4		
	2	1	7		5		
8		6		1	4		2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	8	6	9	1	7	5	3	2
9	1	5	2	3	8	6	4	7
7	2	3	5	4	6	8	9	1
3	4	8	7	2	1	9	6	5
5	9	2	6	8	3	7	1	4
1	6	7	4	5	9	2	8	3
6	3	4	8	7	5	1	2	9
8	7	1	3	9	2	4	5	6
2	5	9	1	6	4	3	7	8

Argëtim filozofik

- Rregulli i artë është se nuk ekzistojnë rregullat e arta.
- Një jetë e kaluar me gabime jo vetëm që është më e nderhme, por më e vlefshme se një jetë e kaluar duke mos bërë asgjë.
- Koha është një mësues i mirë, por i vret të gjithë nxënësit e saj.
- Rinia është e mrekullueshme. Sa krim që shpenzohet më kot tek fëmijët.
- Matritizimi është e vetmja mënyrë si një njeri mund të bëhet i famshëm pa aftësi.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	8	4	2	4		13	1		13	
18	3	1	4		18		5		17	13	1
8	1	10		10		10	1	3	1	6	8
6		1	10	2	3	6	14	1	12	2	4
	13	3	5	4	2	8	4	1	12	4	2
15	9	6	15	1	12	4	6		6	3	18
17	2	4	5	12	2	14		17	5	3	
	8	1	7	6	3	1	10	1			
4	5	12			4	6	4	18	7	7	6
1	A	P	R	E	S		1	5		2	3
13	19		1	3		20	5	4	6	10	6
1	1		10	2	3	2	12	15	18	2	8

R	O	M	A	N	C	I	E	R	E	T	C	
I	R	O	N	L					T	R	U	P
T	R	T	A	R	T	A	R	E	T			
K	A	M	E	R	I	E	R	E	T			
D	E	L	I	R	A	N	T	E	T			
C	K	R	I	P	E	A						
S	L	O	I	L	P	A						
T	A	N	T	A	L	I						
U	S	R	E	K	I	P	I					
F	A	T	A	L	A	L	I	E	N	E	T	
E	T	A	P	A	T	K	A	T	E	T	I	

- -Vlera e një burri është ajo që bën me pushtetin.
- -Vëmendja ndaj shëndetit është pengesa më e madhe në jetë.
- -Një prej dënimeve për refuzim e pjesëmarrjes në politikë është se përfundon e qeverisesh nga inferiorët.

Thënie të mençura

- -Nëse s'e hiqni qafe një skelet të familjes, mund ta bëni të kërcëjë.
- -Ky qytet është ai që është sepse qytetarët tanë janë ata që janë.
- -Kurajoja është të dish se çfarë mos të kesh frikë.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	T	M	L	T	R	A	J	T	A			
P	L	K	A	P	A	L	I	E	N			
R	E	K	O	R	D	E	T	P	M	T	R	
I	M	A	N	S	A	M	B	L	I	H	E	M
I	M	A	R	T	I	N	E	D	E	N	I	N
O	H	A	R	A	T	T	I	T	R	A	T	
B	A	N	A	P	I	S	H	E	I			
E	P	I	T	E	T	E	T	T	E	S	T	
M	I	N	A	T	N	A	I	T	I	M	A	
I	K	A	A	K	R	I	M	A	R			
L	A	P	A	R	A	R	O	J	A			
E	T	I	K	A	S	E	N	A	T	O	R	
K	A	A	S	L	U	L	I	M	A	T	A	
A	R	R	A	S	B	A	R	N	U	M	R	
L	A	T	A	B	R	O	A	E	F	I		
E	L	E	M	E	N	T	A	R	E			
A	N	E	T	A	R	E	S	T	A	I	N	
M	I	N	I	M	A	L	A	L	E	K	O	
I	K	L	I	T	A	R	E	M	A			
E	S	E	N	I	N	E	R	I	E	R		
P	E	N	A	I	M	E	K	N	I			
E	T	N	I	A	S	E	M	I	N	E	M	A
L	O	T	A	S	D	R	I	T	A	T		
A	L	A	I	N	E	M	I	S	A	R	E	T

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

